



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 35/2023 (JR)  
Datë 24.07.2023

Vendim nr. 16 (JR)  
Datë 24.04.2024

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.04.2024, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, me sekretare gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 667, datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat

administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

### **Trupi Gjykes i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

**3.1.** ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Lazër Sallaku, ka dërguar në Komision<sup>1</sup> një raport në të cilin, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ka konstatuar se: deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**3.2.** DSIK-ja, vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës<sup>2</sup>, për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.09.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Lazër Sallaku, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2022, të KDZhsë.

nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Lazër Sallaku.

3.3. KLGj-ja i dërgoi Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale<sup>3</sup> për subjektin e rivlerësimit Lazër Sallaku. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Lazër Sallaku bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, duke marrë në përfundim të procesit vendimin nr. 667, datë 26.05.2023.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 667, datë 26.05.2023, në bazë të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Lazër Sallaku, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
6. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit Lazër Sallaku është marrë pas vlerësimit të të tria kriterëve, bazuar në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit:

*6.1. Nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimin e pikës 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për këtë kriter, dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3, e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

*6.2. Nuk ka rezultuar të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, duke arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

*6.3. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, nuk kanë rezultuar shkelje procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve dhe vlerëson se ka arritur nivel kualifikues, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.*

## III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku i është drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji), me ankim kundër vendimit nr. 667, datë 26.05.2023, të Komisionit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin e tij në detyrë.

---

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2020, të KLGj-së.

8. Lidhur me procesin e zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit në ankim parashtrohet në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe ankimi me natyrë procedurale.

8.1. Gjatë procesit të zhvilluar në Komision i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për t'u mbrojtur dhe dëgjuar në mënyrë efektive dhe denjësisht nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimmarrja e Komisionit është bazuar në dyshime, por edhe këto dyshime janë të pambështetura në prova. Komisioni ka përdorur fakte të shtrembëruara për të justifikuar vendimmarrjen e kundërligjshme e, për pasojë, ndaj tyre duhet të fillojë hetimi disiplinor.

8.2. Komisioni ka vendosur barrë prove të paarsyeshme, jo proporcionale, jo objektive dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 52 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kundërshtim me nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative.

8.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon për shkelje të nenit 6 të Konventës, për shkak se gjykata nuk ka qenë e paanshme dhe e pavarur, duke iu referuar 4 (katër) kritereve të përcaktuara në vendimin e GjEDNj-së në çështjen *Volkov v Ukrainë*, për përcaktimin e organit që vendos masa disiplinore.

8.4. Subjekti ngre pretendime lidhur me zgjedhshmërinë e anëtarëve të Komisionit, madje disa nga anëtarët që shqyrtuan çështjen ndaj tij nuk përmbushin kërkesat e përzgjedhjes të parashikuara me ligjin nr. 84/2016. Mënyra se si anëtarët e Komisionit janë zgjedhur, si dhe disa nga parashikimet ligjore mbi statusin apo kohëzgjatjen e mandatit të tyre, nuk garanton procesin e rregullt ligjor për këtë shkak nuk mund të konsiderohet një gjykatë e paanshme.

8.5. Kryerja e hetimit me kriteret që vendos Komisioni, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit, po nga e njëjta trupë gjykuese e Komisionit, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Në këtë mënyrë, trupa e Komisionit kthehet në një organ me natyrë të dyfishtë, edhe "organ akuzator" edhe "gjykatë".

8.6. Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit ka elementë të theksuar të paragjyqimit, një vendimi të paracaktuar dhe, për këtë arsye, nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, mosrespektimi i garancive procedurale tregon se Komisioni nuk përmbush kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së për t'u konsideruar "gjykatë".

9. **Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.**

9.1. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 86,30 m<sup>2</sup>, ndodhur në Selitë, Tiranë, subjekti pretendon se Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk ka konsideruar si burim krijimi të ligjshëm për këtë pasuri shumën prej 40.000 eurosh, dhuruar ish-bashkëshortes nga nëna e saj.

9.1/a. Subjekti pretendon se dhurimi i shumës prej 40.000 eurosh nga nëna e ish-bashkëshortes së tij në drejtim të ish-bashkëshortes, nuk e bën nënën e saj person të lidhur me të, në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Nuk ka pasur në pronësi ose në bashkëpronësi shumën e parave të nënës së ish-bashkëshortes, nuk ka pasur interesa pasurore

me nënën e ish-bashkëshortes, rrjedhimisht ajo nuk është person tjetër i lidhur si subjekt në kuptim të ligjit dhe, për pasojë, nuk ka pasur dhe nuk ka detyrimin ligjor të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar ish-bashkëshortes A. S..

**9.1/b.** Pasuria e fituar me dhurim e ish-bashkëshortes së tij është pasuri vetjake e saj, nuk bën pjesë në bashkësi (pasuri e përbashkët), referuar përcaktimit të nenit 77/b të Kodit të Familjes: *“Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: (b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë”*.

**9.1/c.** Subjekti pretendon se edhe përtej detyrimit ligjor ka paraqitur dokumentacion për burimin e parave të ish-vjehrrës, duke provuar se këtë shumë ajo e ka pasur në bankë, shumë kohë para se të njihej me të, duke hequr dyshimin se këto para mund të kishin qenë të tijat dhe të ishin kaluar në llogari të ish-vjehrrës.

**9.1/d.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se nuk ka bërë përpjekje për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar nga nëna e ish-bashkëshortes kësaj të fundit, pasi, gjatë hetimit administrativ në Komision, përveç mandatit bankar, ku ish-vjehrra e tij ka tërhequr shumën prej 46.200 eurosh në vitin 2004, janë administruar disa prova të tjera që vërtetojnë burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar.

**9.1/dh.** Lidhur me mosprovueshmërinë e burimit të ligjshëm të shumës së dhuruar, pasi nuk u konfirmuan pasuri në emër e llogari të ish-vjehrrës, subjekti i rivlerësimit pretendon se fakti që AShK-ja nuk përcakton periudhën kohore të kërkimit të këtyre pasurive e bën të parëndësishëm provueshmërinë në rastin konkret.

**9.2.** Komisioni ka paraqitur fakte të pavërteta mbi kohën e përfitimit, kontributin, periudhën kohore të posedimit të kësaj pasurie, transaksionet, pasuritë dhe dhurimet e kryera nga ish-vjehrra e tij, si dhe ka shtrembëruar konkluzionet e ILDKPKI-së.

**9.2/a.** Konstatimin e Komisionit se *pasuria apartament me sipërfaqe 86,30 m<sup>2</sup>, ndodhur në Selitë, Tiranë, është përfituar kur subjekti ka qenë në martesë dhe në detyrë*, subjekti e konsideron fakt të pavërtetë, pasi referuar vendimit gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 30.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është divorcuar me shtetasen A. S. në vitin 2015, ndërsa apartamenti ka kaluar në pronësinë e tij pasi i ka paguar ish-bashkëshortes A. S. shumën prej 45.000 (dyzet e pesë mijë) eurosh, në vitin 2016.

**9.2/b.** Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit se ai ka poseduar në mënyrë të vazhdueshme këtë pasuri duke nisur që prej vitit 2012, pasi ashtu siç ka shpjeguar në pyetësonin standard në periudhën 02.01.2012 - 31.10.2016, ka jetuar në një apartament tjetër me qira, me adresë: ap. nr. {\*\*\*}, Rruga e {\*\*\*} “{\*\*\*}”, Komuna Farkë, Tiranë.

**9.2/c.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur kontribut në blerjen e kësaj pasurie, pasi të gjithë pagesat janë kryer nga ish-bashkëshortja, me paratë e saj të përfituara si pasuri

personale me dhurim dhe me trashëgim, ndërsa kontributi i tij ka qenë vetëm në blerjen e garazhit.

9.3. Lidhur me balancën negative prej 167.503 lekësh të vitit 2010, si dhe diferencën negative prej 1.122.332 lekësh të vitit 2011, subjekti pretendon se janë rrjedhojë e mosllogaritjes nga Komisioni të shumave të përfituara nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi”, në shumën 500.000 lekë, si dhe të mjetit detar, “skaf i vogël”, në vlerën 180.000 lekë, në vitin 2009, këto shuma, si pasojë e një pakujdesie nga ana e tij, nuk janë deklaruar kursime gjendje *cash*.

9.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk e ka ditur faktin se kredia konsumatore e marrë nga ish-bashkëshortja A. S. në vitin 2009 nuk ishte mbyllur që në vitin 2009, pasi ai ia kishte dhënë ish-bashkëshortes paratë e shitjes të automjeteve për ta mbyllur atë kredi. Megjithatë, sipas subjektit, është fakt<sup>4</sup> se ato para kanë qenë gjendje dhe me to është bërë mbyllja e kredisë konsumatore.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Lazër Sallaku duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### b) Legjitimimi i ankuesit

11. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>5</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>4</sup> Këtë fakt subjekti e provon nëpërmjet deklaramëve që ka dhënë në ILDKPKI më datë 14.10.2014, si dhe deklaratës noteriale të ish-bashkëshortes A. M., datë 23.05.2023, e cila konfirmon faktin e mësipërm.

<sup>5</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi nr. 667, datë 26.05.2023, i Komisionit, për rivlerësimin e subjektit Lazër Sallaku, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, më datë 24.06.2023, kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 07.07.2023, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {\*\*\*}, datë 07.07.2023, që rezulton të jetë dita e 14-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku, e ka dorëzuar ankimin e tij në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

Trupi gjykues, pasi kontrolloi vendimin e Komisionit, zhvillimin e procesit të tij të rivlerësimit në Komision, si dhe analizoi dokumentacionin e fashikujve të administruar gjatë hetimit në Komision, vlerësoi se është konstatuar saktë situata faktike dhe nuk janë kryer shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

**B. Vlerësimi i pretendimeve të subjektit mbi aspektet procedurale dhe procesin e rregullt**

12. Subjekti pretendon se gjatë procesit të zhvilluar në Komision i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për t’u mbrojtur dhe dëgjuar në mënyrë efektive dhe denjësisht nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

12.1. Lidhur me sa parashtron subjekti i rivlerësimit, trupit gjykues, pas shqyrtimit të akteve të administruara nga Komisioni, i rezulton se subjektit i janë dhënë të gjitha mundësitë dhe garancitë për t’u mbrojtur, duke iu dhënë e drejta të paraqesë shpjegime në lidhje me: (i) rezultatet e hetimit; (ii) kalimin e barrës së provës për të provuar të kundërtën e asaj çka ka rezultuar nga hetimi; dhe (iii) vlerësimin e provave pas përfundimit të seancës dëgjimore. Hetimi administrativ në kuadër të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit është zhvilluar përgjatë një periudhe më shumë se dyvjeçare (22.07.2020 – 03.05.2023). Përgjatë kësaj periudhe, Komisioni ka mbledhur dhe analizuar informacione nga institucionet qendrore dhe vendore, publike dhe private për subjektin e rivlerësimit për të tria kriteret e rivlerësimit. Po ashtu, Komisioni ka pasur komunikim intensiv me subjektin e rivlerësimit për shkëmbim informacioni dhe ka administruar dokumentacionin provues të përcjellë prej tij. Kronologjia dhe përmbajtja e komunikimeve, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit përgjatë periudhës (19.06.2020 – 03.05.2023), dëshmon se subjekti i rivlerësimit është pyetur, i është dhënë e drejta të njohë aktet, ka dhënë shpjegime dhe ka përcjellë dokumente dhe akte në cilësinë e provave, është ftuar për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, ka marrë pjesë dhe ka parashtruar qëndrimin e tij mbi gjetjet e hetimit të Komisionit.

12.2. Po kështu, nga analiza e shkëmbimeve shkresore mes tij dhe Komisionit dhe e procesverbalit të seancës dëgjimore, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë parashtruar pretendime për shkelje të të drejtave të garantuara në ligj për procesin e rregullt ndaj tij gjatë hetimit administrativ në Komision apo të ketë parashtruar kërkesa specifike që tregojnë apo

pretendojnë njëanshmëri apo mosrespektim të parimeve për një proces të rregullt ligjor gjatë hetimit.

Madje në përfundim të seancës dëgjimore të datës 24.05.2023, subjekti i rivlerësimit Lazër Sallaku është shprehur se [...] *procesi i rivlerësimit ka qenë korrekt, nuk kam asnjë pretendim, asnjë vërejtje, nga ana juaj janë marrë veprimet e duhura në lidhje me hetimin për tre komponentët e vlerësimit kalimtar që i bëhet subjektit në rastin konkret timin, nuk kam asnjë lloj pretendimi në lidhje me atë çfarë ju keni konstatuar [...].*

**12.3.** Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar në fashikujt e Komisionit, rezulton se të tre anëtarët e trupit gjykues të Komisionit kanë deklaruar se nuk gjenden në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Për më tepër, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur kërkesa apo pretendime për konflikt të mundshëm interesi me anëtarët e trupit gjykues, gjë e cila mund të vinte në dyshim paanësinë e gjykimit apo të cenimit të mundshëm të procesit të rregullt ligjor.

**12.4.** Nga përmbajtja e vendimit, konstatohet se Komisioni u është referuar të dhënave të dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit, ka cituar deklaratimet dhe shpjegimet e dhëna prej tij, si dhe ka parashtruar arsyetimin ligjor dhe vlerësimin nëpërmjet konkluzioneve të pasqyruara për secilën gjetje. Në vlerësimin e Komisionit, është krijuar bindja se për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pamjaftueshëm, për kriterin e kontrollit të figurës ka arritur një nivel të besueshëm, ndërsa për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale ka arritur nivel kualifikues. Vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë është rezultat i interpretimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore përkatëse për situatën faktike dhe jo pasojë e moskonsiderimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej tij.

- 13.** Në përfundim të sa analizuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se janë të pambështetura në fakte dhe në provat e administruara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit ndaj tij ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor.
- 14.** Subjekti pretendon se Komisioni ka vendosur barrë prove të paarsyeshme, jo proporcionale, jo objektive dhe në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 52 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kundërshtim me nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative.

**14.1.** Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues çmon të theksojë se kuadri kushtetues dhe ligjor që normon procesin e rivlerësimit kalimtar dhe konkretisht neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 52 i ligjit nr. 84/2016, përcakton se subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të kryer nga Komisioni.

**14.2.** Nga verifikimi i akteve të ndodhura në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në kuptim e zbatim të nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative, ndryshe nga sa pretendon subjekti, ka realizuar detyrimin e tij si organ administrativ duke garantuar të drejtën e subjektit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e



hetimit, si dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime lidhur me gjetjet e rezultuara nga procesi i hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar nëpërmjet komunikimit të rezultateve paraprake të hetimit për çdo çështje apo gjetje të rezultuar nga hetimi, për të cilat ai duhet të jepte shpjegime apo sillte prova, duke i kaluar formalisht barra e provës, në zbatim e kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2006.

**14.3.** Lidhur me këtë pretendim (i cili gjen analizim të plotë në pjesën vijuese të këtij vendimi, që lidhet me vlerësimin e pasurisë), trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar burimet e ligjshme të apartamentit në Tiranë, i cili prej tij është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* si apartamenti ku ai banon. Në këtë kuptim, duke iu referuar përcaktimeve të neneve 30, 32, pika 4 dhe 33, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, me të drejtë, në aplikim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barrën e provës subjektit për të provuar burimet e financimit të kësaj pasurie.

**14.4.** Në kushtet kur, si një nga burimet e krijimit të apartamentit në Tiranë, vetë subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer, ndër të tjera, shuma e parave të dhuruara nga nëna e ish-bashkëshortes, atëherë me të drejtë Komisioni, në referim të dispozitave të sipërcituara, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në zbatim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në vijim të këtij arsyetimi edhe veprimtaria hetimore e Komisionit, në drejtim të nënës së ish-bashkëshortes M. S., (A.) (e cila, gjithashtu, do të analizohet në pjesën vijuese të këtij vendimi), duket se ka nisur nga disa të dhëna të marra në funksion të hetimit administrativ, pasi Komisioni ka marrë informacionet zyrtare nga organet ndihmëse si ASHK-ja, Regjistri i Noterëve të Shqipërisë, etj., dhe i ka kërkuar sërish shpjegime subjektit, veprime këto të cilat përfshihen brenda diskrecionit për veprimtarinë hetimore të Komisionit gjatë procesit administrativ.

**14.5.** Për sa më lart, trupi gjykues vlerëson se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, për sa i përket marrëdhënies së interesave pasurore të subjektit me ish-bashkëshorten duket të jetë normale dhe e arsyeshme për natyrën dhe objektin e hetimit administrativ, në kushtet kur neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kërkon të verifikohet nëse subjektet e rivlerësimit kanë burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë që disponojnë. Në këtë kuptim, kjo pistë e hetimit administrativ ka pasur për qëllim të verifikonte të drejtat reale që i përkisnin subjektit të rivlerësimit për veprimet juridike të kryera prej ish-bashkëshortes së tij dhe nënës së saj, si edhe në raport me pasuritë që janë të regjistruara në emër të nënës të saj. Në funksion të këtij qëllimi, subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës, e cila vjen në përputhje me qëllimin e këtij procesi për vlerësimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të tij.

**14.6.** Kalimi nga ana e Komisionit i barrës së provës subjektit të rivlerësimit ka pasur për qëllim të përcaktojë rrethanat e fakteve të çështjes që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit, brenda afateve të arsyeshme, në përputhje me ligjin. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe proporcional procesin hetimor që Komisioni ka zhvilluar në këtë drejtim dhe brenda kufizimeve që ka parashikuar neni A i Aneksit të Kushtetutës

15. Për sa i përket shkakut ankimor të subjektit të rivlerësimit se *vendimmarrja e Komisionit është bazuar në dyshime, por edhe këto dyshime janë të pambështetura në prova, si dhe ka përdorur fakte të shtrembëruara për të justifikuar vendimmarrjen e kundërligjshme e, për pasojë, ndaj tyre duhet të fillojë hetimi disiplinor*, trupi gjykues sqaron se ky pretendim i tij do të analizohet më poshtë në këtë vendim, së bashku me shkaqet e ankimit me natyrë materiale që lidhen me analizimin e problematikave të pasurive të subjektit të rivlerësimit.
16. Subjekti pretendon se kryerja e hetimit me kriteret që vendos Komisioni, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për të, po nga e njëjta trupë gjykuese e Komisionit, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, duke e kthyer trupën gjykuese të Komisionit në një organ me natyrë të dyfishtë, edhe “organ akuzator” edhe “gjykatë”.

16.1. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit<sup>6</sup> në jurisprudencën e tij se kompetenca e Komisionit, për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin, është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit kalimtar, si një proces administrativ i nisur kryesisht, në përputhje me kompetencën që i njeh Kushtetuta dhe kreu VII, “Procedura e rivlerësimit”, i ligjit nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit.

Në paragrafët 307 dhe 308 të vendimit që i përket çështjes *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, GjEDNj-ja, shprehet se: 307. *Në momentin që KPK-ja mori vendimin, në përfundim të procesit, ai vlerësoi nëse provat e marra, përfshirë argumentet dhe dokumentet e parashtruara nga kërkuesja si përgjigje, mjaftonin për ta konfirmuar atë në postin e saj ose për të vendosur një sanksion disiplinor në përputhje me ligjin nr. 84/2016 [...]. Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, jo në përfitim të mbrojtjes së kërkueses, nuk mund të konsiderohet se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të kërkueses në seancë publike. Ajo që është e rëndësishme është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjithë elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë [...].*

308. *Prandaj, nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së.*

16.2. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera, në çështjet *Morel kundër Francës*, *Hauschildt kundër Danimarkës* etj., në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, njohja e thelluar e dosjes nga gjyqtari nuk nënkupton një paragjykim që e pengon të konsiderohet si i

---

<sup>6</sup> Shih vendimin nr. 4, datë 09.02.2021 (paragrafi 8), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

paanshëm në momentin e gjykimit në themel dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nuk mund të çojë në paragjykimin e vlerësimit përfundimtar<sup>7</sup>.

17. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit për cenim të parimit të paanshmërisë, pavarësisë, si dhe procesit të rregullt ligjor, për shkak se e njëjta trupë gjykuese heton dhe vendos, është i pabazuar.
18. Në kuadër të respektimit të parimit të pavarësisë, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje çështjen e GjEDNj-së *Volkov kundër Ukrainës* lidhur me kriteret që duhet të përmbushë një organ që vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve për të qenë i pavarur dhe i paanshëm, si: (i) përfaqësimi thelbësor i gjyqtarëve; (ii) mënyra e caktimit të anëtarëve të organit dhe ekzistenca e garancive ndaj presioneve të jashtme; (iii) dublimi i funksioneve [hetimor dhe vendimmarrës] mund të hedhë dyshime objektive mbi paanshmërinë e tyre; si dhe (iv) kohëzgjatja e mandatit. Sipas subjektit, të gjitha aktet ndërkombëtare, që synojnë të garantojnë pavarësinë e gjyqësorit, përcaktojnë se gjysma e organit që cakton masën disiplinore të shkarkimit të jenë gjyqtarë, që në momentin e emërimit janë në sistemin gjyqësor, si në rastin e KLGj-së dhe KLP-së.

**18.1.** Subjekti ngre pretendime lidhur me zgjedhshmërinë<sup>8</sup> e anëtarëve të Komisionit, madje sipas tij, disa nga anëtarët që shqyrtuan çështjen ndaj tij nuk përmbushin kërkesat e përzgjedhjes të parashikuara me ligjin nr. 84/2016. Mënyra se si anëtarët e Komisionit janë zgjedhur, si dhe disa nga parashikimet ligjore mbi statusin apo kohëzgjatjen e mandatit të tyre, nuk garanton procesin e rregullt ligjor për shkak se nuk mund të konsiderohet një gjykatë e paanshme.

**18.2.** Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit ka elementë të theksuar të paragjykimit të një vendimi të paracaktuar dhe, për këtë arsye, nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, mosrespektimi i garancive procedurale tregon se Komisioni nuk përmbush kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së për t'u konsideruar "gjykatë".

19. Trupi gjykues vëren se ky grup pretendimesh lidhet me funksionimin dhe organizimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore dhe jo me veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit që lidhen me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit individualisht.

**19.1.** Trupi gjykues çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit, që në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t'i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare.

---

<sup>7</sup> Paragrafët 142 – 163 të Udhëzuesit mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – E drejta për një proces të rregullt, (aspekti civil) - [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_SQI.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SQI.pdf).

<sup>8</sup> Subjekti i referohet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 17.07.2020, të Avokatit të Popullit, në të cilën, sipas tij, jepen shpjegime të papranueshme për kualifikimin e kandidaturave që nuk plotësojnë kriteret ligjore për t'u zgjedhur në organet e rivlerësimit, duke lënë të nënkuptohet se ata janë zgjedhur për shkak të afërsisë së tyre me partitë politike.

Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t'i paraprinte emërimin fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t'i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit kalimtar.

**19.2.** Në këtë analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, referuar dhe jurisprudencës<sup>9</sup> së Kolegjit, trupi gjykues çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet parimi i sigurisë ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për mospërbushje të kushteve të zgjedhshmërisë për dy anëtarët që kanë gjykuar çështjen e tij në Komision, nuk gjendet i bazuar.

**19.3.** Parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016 kanë vendosur kriteret specifike për zgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, të cilat janë të ndryshme me kriteret e vendosura për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Kriteret e zgjedhjes në detyrë të komisionerëve janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, ku referuar parashikimeve të nenit 6, pika 1, shkronja “ë” e ligjit, bie në sy fakti se qenia gjyqtar apo prokuror gjatë dy viteve të fundit para kandidimit përcaktohet si kriter përjashtues në vlerësimin e kandidaturave për t'u zgjedhur komisionerë.

Për më tepër, vlen të theksohet fakti që ligji nr. 84/2016 i është nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë e tij nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, ka arsyetuar: *Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra, organet që kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Gjykata ka theksuar se me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet [...].* Për sa më sipër, fakti që anëtarët e Komisionit nuk plotësojnë kushtet e zgjedhshmërisë së anëtarëve të Gjykatës së Lartë nuk vlerësohet se përbën cenim të parimit të gjykatës së krijuar me ligj.

**19.4.** Në vazhdim të analizës së këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit, si

---

<sup>9</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 43/2022 (JR), datë 15.11.2022; nr. 3/2023 (JR), datë 06.02.2023.

pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar nga GjEDNj-ja, e cila në vendimin e saj, lidhur me çështjen gjyqësore *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, ka arsyetuar se: “[...] Për sa i përket mos përfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kish pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tre kriterëve dhe ka për qëllim rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është “sui generis” dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin. Ajo vëren se këto anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj. Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë [...]”. GjEDNj-ja në vijim ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar, për rrjedhojë shkelje të nenit 6 të KEDNj-së lidhur me sa më sipër.

19.5. Në analizë të dispozitave ligjore të zbatueshme dhe dokumentacionit në fashikull e pretendimeve të subjektit, trupi gjykues arrin në përfundimin se veprimet e Komisionit kanë qenë në përputhje me elementët që ofrojnë garanci për një proces të rregullt ligjor.

**C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material**

**20. Për pasurinë apartament me sip. 86,30 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 22,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Selitë, Tiranë**

20.1. Për këtë pasuri, Komisioni në vendimin përfundimtar ka konkluduar se *në kushtet që nga ana e subjektit nuk është paraqitur ndonjë dokument ligjor për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, çmoi se shuma e dhuruar nuk duhet të merret në konsideratë dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultojnë në pamundësi financiare për të krijuar gjendjen cash në shumën 40.000 euro, si dhe të përballonin shpenzimet e tjera familjare në shumën (-) 4.857.593 lekë në vitin 2012. Si rrjedhojë e mosmarrjes në konsideratë edhe të pretendimeve të subjektit sa i takon balancave negative për vitet 2010 – 2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare të krijojë kursimet, si dhe, më pas, këto kursime t'i investojë në*

*pasurinë apartament dhe garazh, në një shumë totale prej (-) 6.147.428 lekësh për vitet 2010 – 2012.*

**20.2.** Komisioni ka vlerësuar se për dhuratën e bërë ndaj ish-bashkëshortes nga nëna e saj në shumën 40.000 euro nuk është provuar ligjshmëria e burimit të krijimit të kësaj pasurie, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, nuk e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare.

**20.3.** Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke mos paraqitur plotësisht realitetin dhe, për rrjedhojë, ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, konkluzione të cilat kualifikohen në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, përbëjnë shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

- 21.** Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, në pjesën më të madhe të tij ka paraqitur argumente kundër konkluzionit të Komisionit, për moskonsiderimin si burim krijimi të ligjshëm për këtë pasuri të shumës prej 40.000 eurosh, dhuruar ish-bashkëshortes nga nëna e saj, si dhe ka kundërshtuar detyrimin e tij për justifikimin e shumës së dhuruar duke pretenduar se:
- i.* dhurimi i shumës prej 40.000 eurosh nga nëna e ish-bashkëshortes së tij në drejtim të ish-bashkëshortes, nuk e bën nënën e saj person të lidhur me të, në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, pasi këto dispozita nuk parashikojnë që personi tjetër i lidhur i personit të lidhur të subjektit e bën atë person tjetër të lidhur edhe të subjektit të rivlerësimit;
  - ii.* nuk ka pasur kontribut në blerjen e kësaj pasurie, pasi gjithë pagesat janë kryer nga ish-bashkëshortja me paratë e saj të përfituara si pasuri personale me dhurim dhe trashëgimi, ndërsa kontributi i tij ka qenë vetëm në blerjen e garazhit;
  - iii.* pasuria e fituar me dhurim e ish-bashkëshortes është pasuri vetjake e saj, nuk bën pjesë në bashkësi (pasuri e përbashkët), referuar përcaktimit të nenit 77/b të Kodit të Familjes: *“Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: (b) Pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë”*;
  - iv.* nuk ka pasur në pronësi ose në bashkëpronësi shumën e parave të nënës së ish-bashkëshortes, nuk ka pasur interesa pasurore me nënën e ish-bashkëshortes, rrjedhimisht ajo nuk është person tjetër i lidhur si subjekt në kuptim të ligjit dhe, për pasojë, nuk ka pasur dhe nuk ka detyrimin ligjor të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar ish-bashkëshortes A. S..
- 22.** Me qëllim krijimin e një panorame sa më të qartë të ngjarjeve dhe fakteve, trupi gjykues fillimisht mori në shqyrtim deklaratimet e subjektit ndër vite për këtë pasuri, ndërsa shkaqet ankimore, të cilat lidhen me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në mënyrë të detajuar do t'i analizojë në vijim në përputhje me dokumentacionin, deklaratimet e subjektit dhe konstatimet e Komisionit.

22.1. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me nr. {\*\*\*}, i ndodhur në Selitë, Tiranë, regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në zonën kadastrale {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, me sipërfaqe fizike 86,30 m<sup>2</sup>, sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, më datë 08.11.2016. Paguar kësti i parë 10.000 euro, parapaguar për rezervim më datë 06.02.2014, kësti i dytë 20.727 euro paguar me nënshkrimin e kontratës më datë 24.12.2014, marrëveshje e lidhur me kontratën e sipërmarrjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2014, kësti i tretë 15.596 euro, paguar më datë 09.06.2016 dhe lidhur kontrata e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.10.2016.

“Garazh nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 22,9 m<sup>2</sup>, në kompleksin rezidencial “{\*\*\*}”, Selitë, Njësia Administrative Farkë, Tiranë, me nr. pasurie {\*\*\*}, regjistruar në z. k. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}, parapaguar në datën 13.10.2016 me kontratën e premtim shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.10.2016”.

Burimi i të ardhurave: Të ardhura nga paga. Të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese. Dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj. Pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga babai i saj. Vlera: 46.322 euro. Zotëron: 50 %”. Subjekti i ka bashkëgjetur deklaratës vetting disa dokumente<sup>10</sup>.

---

<sup>10</sup> Certifikatë pronësie nr. {\*\*\*}, lëshuar më datë 08.11.2016, për pasurinë nr. {\*\*\*}, e ndodhur në Selitë, Tiranë, me sipërfaqe 86,3 m<sup>2</sup>, në zotërim në pjesë të barabartë nga subjekti dhe A. S. S.. Kopje karteletë të pasurisë lëshuar më datë 08.11.2016, me vlerë blerje 46.322 euro; kontratë shitblerje (pasuri e paluajtshme) nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.10.2016, për blerjen e apartamentin nr. {\*\*\*}, ndodhur në Selitë, Tiranë, me sipërfaqe 86,3 m<sup>2</sup>, në vlerën 46.322 euro, me palë shitëse “{\*\*\*}” ShPK dhe palë blerëse A. S. (S.) e Lazër Sallaku. Çmimi për blerjen e kësaj pasurie është likuiduar nga blerësi në ekzekutim të detyrimeve të kontratës për ndërtim apartamenti nr. {\*\*\*}, datë 15.12.2014. Kopje kartash identiteti të palëve. Ekstrakt i regjistrimit të shoqërisë ndërtuese me NIPT {\*\*\*}. Certifikatë pronësie nr. {\*\*\*}, lëshuar më datë 10.06.2015, në pronësi të firmës ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK. Dy kopje karteletë në pronësi të firmës ndërtuese. Plan rievimi i sipërfaqes 86,3 m<sup>2</sup> të apartamentit. Kontratë sipërmarrje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2014, për blerjen e apartamentit nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe totale 100,7 m<sup>2</sup>, ku përfshihet dhe sipërfaqja e përbashkët, në vlerën 46.322 euro. Pagesa do të kryhet e ndarë në tre këste, ku kësti i parë në shumën 10.000 euro është parapaguar nga porositësit A. S. dhe Lazër Sallaku më datë 06.02.2014, kësti i dytë në shumën 20.727 euro do të paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe kësti i tretë në shumën 15.595 euro do të paguhet deri më datë 30.8.2015; nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank e llogarisë në emër të “{\*\*\*}” ku është kryer transaksioni bankar më datë 06.02.2014, në shumën 10.000 euro, nga A. S. për llogari të shoqërisë ndërtuese; transaksion bankar në bankën Credit Agricole Albania, nr. {\*\*\*}, datë 24.12.2014, në shumën 20.725 euro, nga A. S. për llogari të shoqërisë ndërtuese; transaksion bankar në Raiffeisen Bank, nr. {\*\*\*}, datë 09.06.2016, në shumën 15.596 euro, nga A. S. për llogari të shoqërisë ndërtuese; deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.03.2013, nga M. A. e cila i dhuron shumën 40.000 euro vajzës së saj A. S. me rastin e martesës; mandatpagesë datë 12.02.2004, i Alpha Bank për tërheqjen nga M. S. të shumën 46.200 euro nga llogaria e saj në këtë bankë me nr. {\*\*\*}. Aneks nr. {\*\*\*} në dosjen e ILDKPKI-së. Dëshmi trashëgimie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.12.2013, me të cilën bashkëjetuesja e subjektit ka fituar të drejtën e trashëgimisë si trashëgimtare ligjor me ½ pjesë të trashëgimlënësit S. S.; kontratë shitblerje për pasuri të paluajtshme (me rezervë, me kusht) nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.07.2014, për blerjen e apartamentin me nr. {\*\*\*}, ndodhur në z. k. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}, me sipërfaqe 57,6 m<sup>2</sup>, në vlerën 32.000 euro (palë shitëse E. S. dhe A. S. dhe palë blerëse E. M. dhe V. M.). Kopje karteletë lëshuar më datë 14.07.2014 në pronësi të A. dhe A. S. (S.) në bashkëpronësi me pjesë të barabartë; hartë treguese e regjistrimit të pronës; transaksion bankar datë 08.08.2014, në vlerën 32.000 euro, për pagesën totale të apartamentit nga E. M. tek A. dhe E. S.; transaksion bankar datë 29.08.2014, nga banka NBG nga A. S., në shumën 16.000 euro, me

22.2. Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 me përshkrimin: “Pakësim i gjendjes cash nga pagimi i dy kësteve për shoqërinë “{\*\*\*}” sh.p.k. për ndërtimin e një apartamenti me adresë Komuna Farkë, Rezidenca {\*\*\*}, në objektin {\*\*\*}, Rruga e {\*\*\*}, apartamenti nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe ndërtimore 100,7 m<sup>2</sup> përfshirë sipërfaqen e përbashkët, 2+1. Kësti i parë 10.000 euro, parapaguar për rezervim më datë 06.02.2014 dhe kësti i dytë 20.727 euro paguar me nënshkrimin e kontratës më datë 24.12.2014, marrëveshje e lidhur me kontratën e sipërmarrjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2014. Burimi i krijimit: nga gjendja cash. Vlera: 30.727 euro”.

22.3. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “Pakësim i gjendjes cash me pagimin e kështit të tretë 15.596 euro paguar më datë 09.06.2016 dhe lidhur kontrata e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.10.2016, për apartament me nr. {\*\*\*}, ndodhur në Selitë, Tiranë, regjistruar në Zyrën Vendore Të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në zonën kadastrale {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, me sipërfaqe fizike 86,3 m<sup>2</sup>, sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë më datë 08.11.2016. Burimi i krijimit: (i) nga gjendja cash e kursyer nga të ardhurat nga paga; (ii) të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese; (iii) dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj; (iv) pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetueses nga babai i saj”.

“Pakësuar gjendja cash me pagimin e 7.547 eurove, parapaguar më datë 13.10.2016, me kontratë premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.10.2016, e garazh nr. {\*\*\*} me sip. 22,9 m<sup>2</sup>, në Kompleksin Rezidencial {\*\*\*} në Selitë, Njësia Administrative Farkë, Tiranë, me nr. pasurie {\*\*\*} regjistruar në z. k. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}. Vlera: 7.547 euro. Pjesa në %: 50%. Burimi: Nga gjendja cash e kursyer nga të ardhurat nga paga; të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese; dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj; pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga babai i saj”.

23. Trupi gjykues mori në shqyrtim konkluzionet e mësipërme të Komisionit, në funksion të analizimit të pretendimeve të subjektit të paraqitura në ankim, duke ia nënshtruar kontrollit këto çështje, në raport me dokumentacionin e administruar, legjislacionin përkatës, jurisprudencën e Kolegjit<sup>11</sup>, për kufijtë e kontrollit të ushtruar ndaj personave të tjerë të lidhur, dhe vlerëson se:

Së pari, objekt i kontrollit në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar është pasuria në pronësi e subjektit të rivlerësimit, siç rezulton të jetë pasuria apartament me sip. 86,30 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 22,9 m<sup>2</sup> ndodhur në Selitë, Tiranë, e cila i nënshtrohet vlerësimit në drejtim të ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj. Ky detyrim rrjedh nga parashikimi i nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pikat 11 dhe 13, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjendet i

---

përshkrim tërheqje nga shitja e apartamentit (mbajtës të llogarisë A. S. dhe E. S.). Aneks nr. {\*\*\*}, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>11</sup> Vendimi nr. 4/2021 (JR) E. B., paragrafi 147; vendimi nr. 15/2019 (SR) D. Rr., paragrafi 107-110; vendimi nr. 21/2020 (SR) R. J., paragrafi 74; vendimi nr. 36/2023 (SR) E. M., paragrafi 18, 19, 20.



pasqyruar nëpërmjet detyrimit për deklarim në shtojcën 2 të po këtij ligji. Në këtë kuptim, kontrolli i ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive merr një peshë specifike në procesin e rivlerësimit dhe subjekti i rivlerësimit duhet ta justifikojë atë.

*Së dyti*, këto dispozita, por edhe në tërësi përmbajtja e ligjit nr. 84/2016, veçanërisht e nenit 30 të tij, përcaktojnë se nivelet e kontrollit të pasurisë dhe ligjshmërisë së burimeve të krijimit për personin e lidhur (në këtë rast bashkëshortja) janë të barasvlershme me ato të parashikuara, si edhe për subjektin e rivlerësimit. Për vetë rëndësinë që ka procesi i rivlerësimit kalimtar, dispozitat ligjore në fuqi nuk kanë vendosur kufij apo kufizime në drejtim të këtij kontrolli, duke lënë në diskrecion të organeve të rivlerësimit më pas vlerësimin e rezultateve të këtij kontrolli, si edhe të rezultateve të hetimit në përgjithësi, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Por zbatimi i këtyre parimeve nuk sjell pengesa apo kufizime për nivelin e kontrollit, me qëllim arritjen e një konkluzioni sa më të drejtë që i afrohet sa më shumë të vërtetës jetësore të subjekteve dhe personave të lidhur në raport me krijimin e pasurive të tyre. Në këto kushte, sa kohë që rezultojnë se dhurimi midis bashkëshortes së subjektit dhe nënës së saj është bërë pas lidhjes së martesës ligjore<sup>12</sup> dhe në funksion të saj, si dhe gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit ka qenë në ushtrim të detyrës, duke shërbyer si burimi kryesor për blerjen e apartamentit tek i cili ai banon, për shkak të parashikimit ligjor, dhuruesja (vjehra e subjektit) duhet të konsiderohet si person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

24. Në kushtet kur pasuritë objekt shqyrtimi dhe njëri prej burimeve të krijimit të tyre (dhurimi i shumës prej 40.000 eurosh) janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka detyrimin ligjor të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të saj. Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 e ngarkon subjektin e rivlerësimit, personin e lidhur ose personin tjetër të lidhur, që në kuadër të marrëdhënies së dhurimit të konfirmuar me dokument noterial nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.03.2013, të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhuruar që ka shërbyer për krijimin e pasurisë që subjekti ka përfituar. Edhe nëse do të pranohej pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me kualifikimin e marrëdhënies që nëna e ish-bashkëshortes nuk është person tjetër i lidhur me të në funksion të provimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të shumës së dhuruar, kjo nuk e përjashton subjektin dhe personin e lidhur nga detyrimi për të provuar ligjshmërinë e burimit të shumës së dhuruar, i cili prevalon në raport me kualifikimin e marrëdhënies.
25. Lidhur me pretendimin e subjektit se për përcaktimin e pasurisë dhe regjimit pasuror duhet referuar në dispozitat e Kodit të Familjes<sup>13</sup> konkretisht në neni 77/b të tij, sipas së cilit pasuria e fituar me dhurim e ish-bashkëshortes së tij është pasuri vetjake e saj dhe, si e tillë, nuk bën pjesë në bashkësi (pasuri e përbashkët), trupi gjykues çmon se shuma e dhuruar prej 40.000 eurosh nuk mund të konsiderohet pasuri vetjake e ish-bashkëshortes së tij në kuptim të dispozitave të Kodit të Familjes, lexuar këto në harmoni me dokumentacionin e administruar dhe faktet e konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit.

<sup>12</sup> *Martesa midis subjektit dhe bashkëshortes është lidhur më datë 05.06.2012.*

<sup>13</sup> *“Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: (b) Pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë”.*

25.1. Trupi gjykues vëren se referuar Kodit të Familjes, Kreu II, “Regjimi martesor në bashkëpronësi”, neni 74 i tij, mbi përbërjen e bashkësisë në regjimin martesor, ka parashikuar se: *“Bashkësia përbëhet nga: (a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës; neni 76 përcakton se: pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak”*.

Nga aktet e çështjes së ndodhur në fashikullin e Komisionit rezultoi se: (i) shuma është dhuruar në funksion të martesës, ashtu siç ka deklaruar nëna e ish-bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.03.2013, në të cilën, ndër të tjera, citohet se *shtetasen A. S. e ka vajzë dhe me rastin e martesës së saj i ka dhuruar një shumë prej 40.000 eurosh*, për pasojë dhurimi prezumohet i përbashkët; (ii) në aktin e dhurimit nuk ka ndonjë parashikim për karakterin vetjak të shumës së dhuruar për bashkëshorten e subjektit, si dhe as nuk rezulton ndonjë akt tjetër për këtë gjë, për rrjedhojë dispozita ligjore e Kodit të Familjes (neni 76) është lexuar dhe interpretuar në mënyrë të gabuar nga subjekti; (iii) shuma e dhuruar prej 40.000 eurosh është deklaruar vetëm nga subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2012 në pjesën takuese 50%, ndërsa bashkëshortja e tij nuk e ka deklaruar këtë dhurim në këtë deklaratë; (iv) subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në DPV-në e vitit 2012 se kjo shumë ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e pasurisë apartament dhe garazh, e cila është regjistruar me pjesë 50% me bashkëshorten e tij. Argumentet e mësipërme konfirmojnë faktin se shuma e dhuruar është pjesë e bashkësisë ligjore dhe prezumohet si pasuri e përbashkët e bashkëshortëve, për rrjedhojë pretendimi i subjektit është i pabazuar.

26. Nga sa më lart konstatuar, trupi gjykues çmon të theksojë se referuar ligjit nr. 84/2016 objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet detyrimit ligjor, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, në raport me situatën faktike të kësaj çështjeje, duke marrë përsipër dhe pasojat që sjell mosprovueshmëria e kësaj të ardhure në procesin e rivlerësimit.
27. Në kuadër të kontrollit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi dhe parashikimit ligjor të sa më lartarsyetuar, trupi gjykues vlerëson se për shumën e parave dhuruar nga nëna e ish-bashkëshortes, që ka shërbyer më pas për blerjen e apartamentit ku ka jetuar dhe jeton aktualisht subjekti i rivlerësimit, ky i fundit kishte detyrimin të shpjegonte bindshëm burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar. Madje edhe në versionin që kjo pasuri do t'i takonte bashkëshortes së subjektit, përsëri ai ka detyrimin ligjor për të provuar burimet e ligjshme të krijimit të saj, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.
28. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit *se nuk ka pasur kontribut në blerjen e kësaj pasurie, pasi të gjithë pagesat janë kryer nga ish-bashkëshortja, me paratë e saj të përfituara si pasuri personale me dhurim dhe me trashëgim, ndërsa kontributi i tij ka qenë vetëm në blerjen e garazhit*, trupi gjykues konstaton se ky pretendim është i pabazuar. Ky konstatim vjen

pasi trupi gjykues mori në shqyrtim dhe analizoi dokumentacionin e ndodhur në dosjen e Komisionit lidhur me evidentimin e pagesave të kryera dhe deklaratimet e subjektit nga ku rezultoi se:

**28.1.** Me kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2014, pala porositëse A. S. dhe Lazër Sallaku kanë porositur pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK apartamentin nr. {\*\*\*}, me sip. 100,7 m<sup>2</sup>, me adresë Komuna Farkë, Rezidenca “{\*\*\*}”, në objektin {\*\*\*}, Rruga e {\*\*\*}. Vlera totale e porosisë së apartamentit është 46.322 euro, e cila është likuiduar në mënyrë periodike si më poshtë:

- Kësti i parë: 10.000 euro, parapaguar më datë 06.02.2014 për rezervimin (sipas “nxjerrje llogarie e shitësit”, ku A. S. depoziton këst apartamenti në llogarinë bankare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në Raiffeisen Bank).
- Kësti i dytë: 20.727 euro, paguar më datë 24.12.2014 (*kalim nga A. S. te shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, për blerje apartamenti, sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2014 (transferim fondesh i brendshëm në bankën Credit Agricole).*
- Kësti i fundit: 15.595 euro deri më 30.08.2015 (*A. S. depoziton në llogarinë bankare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në Raiffeisen Bank, likuidim këst i fundit blerje apartamenti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2014).*

**28.2.** Ndërsa për pasurinë garazh, me sipërfaqe prej 22,9 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Selitë, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka depozituar së bashku me deklaratën *vetting*, kontratën premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.10.2016, me palë shitëse A. dhe M. S. dhe palë blerëse A. S. (S.) dhe Lazër Sallaku, për blerjen e një pjese 22,9 m<sup>2</sup> garazh {\*\*\*}, me çmim prej 7.547 eurosh, e cila parashikohej të paguhej me nënshkrimin e kontratës. Kjo vlerë sipas akteve<sup>14</sup> dorëzuar nga subjekti është likuiduar pas lidhjes së kontratës më datë 13.10.2016.

- 29.** Trupi gjykues konstaton se deklaratimet e subjektit lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie janë kontradiktore, pasi në deklaratën e interesave periodike të vitit 2014 ai ka deklaruar si burim krijimi *nga gjendja cash*, për pagesat e kryera shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, konkretisht për këstin e parë në vlerën prej 10.000 eurosh, parapaguar më datë 06.02.2014 dhe këstin e dytë në vlerën prej 20.727 eurosh paguar më datë 24.12.2014. Ndërsa në deklaratën e interesave periodike të vitit 2016 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti, në ndryshim nga sa ka deklaruar në DPV-në 2014, ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit dhe garazhit të ardhurat nga paga e tij, të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese, dhuratën e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj, si dhe pjesën e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga babai i saj.
- 30.** Subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 5, pyetja nr. 1, ka shpjeguar se lidhur me blerjen e pasurive kanë kontribuar respektivisht [...] *ish-bashkëshortja ka paguar për shtëpinë 45.000 euro, pjesa tjetër prej 1.323 eurosh është paguar nga ana ime me të ardhurat nga paga, ndërsa garazhin e kemi paguar së bashku. Por përfundimisht, kjo ka qenë marrveshja e mundëshme*

---

<sup>14</sup> Sipas mandatit depozitim për të tretë në 13.10.2016, në Raiffeisen Bank, me vlerë 7.547 euro, për A. S. nga A. S. me përshkrim “garazh derdhje në llog për kontratë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.”.

*për të zgjidhur situatën ku ndodheshim në atë kohë, pra, edhe referuar përgjigjeve të vetë subjektit, rezulton se ai ka kontribuar për apartamentin dhe për garazhin minimalisht në vlerat e deklaruara prej tij.*

31. Gjithashtu, një fakt tjetër që rrëzon pretendimin e subjektit është dhe deklarimi i tij në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilat ka deklaruar se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer dhe *të ardhurat nga paga*, pra të tij, dhe nga *pakësimi i gjendjes cash*, që ka filluar të deklarohen që në vitin 2010 e 2011, pra, para martesës me ish-bashkëshorten A. S..
32. Për sa analizuar më lart, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie, e cila është derivat i kursimeve bashkëshortore në *cash*, përfshirë edhe dhurimin prej vitit 2012 e deri në vitin 2014 kur janë kryer pagesat, kohë kur subjekti, po ashtu, ka qenë në detyrë. Deklarimi prej subjektit në deklaratën e interesave periodike të vitit 2012, të dhurimit të shumës prej 40.000 eurosh në përqindje të barabartë me ish-bashkëshorten në vlerën 50%, si dhe mosdeklarimi i dhurimit të kësaj shume nga bashkëshortja e tij në DPV-në e vitit 2012, vërtetojnë faktin se për krijimin e kësaj pasurie kanë kontribut të përbashkët si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe ish-bashkëshortja e tij.
33. Subjekti i rivlerësimit e konsideron fakt të pavërtetë konstatimin e Komisionit *se pasuria apartament objekt shqyrtimi është përfituar kur subjekti ka qenë në martesë dhe në detyrë nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep, nr. {\*\*\*} kol., datë 31.10.2016*, pasi referuar vendimit gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 30.06.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është divorcuar me shtetasen A. S. në vitin 2015. Apartamenti me sipërfaqe 86,30 m<sup>2</sup>, ndodhur në Selitë, Tiranë, ka kaluar në pronësinë e tij, pasi i ka paguar ish-bashkëshortes A. S. shumën prej 45.000 (dyzet e pesë mijë) eurosh, në vitin 2016, duke ia blerë praktikisht këtë pasuri ish-bashkëshortes.
34. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues vëren se është i vërtetë fakti se kontrata e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., për apartamentin objekt shqyrtimi, është nënshkruar nga palët në datën 31.10.2016, në një kohë që subjekti i rivlerësimit ka qenë i divorcuar me vendimin nr. {\*\*\*}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 30.06.2015, nuk përbën ndonjë rrethanë të veçantë në analizimin e kësaj pasurie, për sa kohë A. S. ka deklaruar pasurinë e mësipërme në deklaratën *vetting* në cilësinë e personit të lidhur, për shkak të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit. Nga aktet në dosjen e Komisionit, rezulton se kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2014, me palë sipërmarrëse shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe palë porositëse A. S. dhe Lazër Sallaku, për porositjen e apartamentit me sip. 100,7 m<sup>2</sup>, me adresë Komuna Farkë, Rezidenca “{\*\*\*}”, në vlerën 46.322 euro, është lidhur gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë qenë të martuar. Po kështu, edhe likuidimi i dy kësteve lidhur me këtë pasuri është kryer gjatë martesës së tyre konkretisht: kësti i parë: 10.000 euro parapaguar më datë 06.02.2014 dhe kësti i dytë: 20.727 euro paguar më datë 24.12.2014.

35. Pavarësisht nga këto fakte të renditura më lart, në analizimin e situatës faktike të kësaj pasurie, trupi gjykues çmon të theksojë se për sa kohë kjo pasuri është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, figuron në pronësi të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe banon aktualisht, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të deklarojë dhe justifikojë burimin e ligjshëm të krijimit të saj.
36. Në vijim të analizimit të këtij shkaku ankimi, trupit gjykues i rezulton se lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 86,30 m<sup>2</sup> dhe garazh me sipërfaqe 22,9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Selitë, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, ka deklaruar: *“Paguuar shuma 45.000 (dyzet pesë mijë) euro, ish-bashkëshortes A. S., sipas marrëveshjes për ndarje pasurie dhe regjimi pasuror për zgjidhje martesë me nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 24.10.2017, e cila heq dorë nga pjesa e saj si bashkëpronare për pasurinë e paluajtshme apartament me sipërfaqe fizike 86,30 m<sup>2</sup> i ndodhur në Selitë, Tiranë, regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë me nr. {\*\*\*}, në zonën kadastrale {\*\*\*}, volumi {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, si dhe për pasurinë parkim/garazh nr. {\*\*\*}, ende i pa hipotekuar me sipërfaqe 22,9 m<sup>2</sup>, pjesë e pasurisë nr. {\*\*\*}, në Kompleksin Rezidencial “{\*\*\*}”, në Selitë, Tiranë. Burimi i krijimit: Hua 11.000 (njëmbëdhjetë mijë) euro marrë me kontratën e huas me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.10.2017, me afat kthimi prej 5 vjetësh, dhe 36 (tridhjetë e gjashtë mijë) euro, marrë me marrëveshje financimi nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë, për një afat shlyerjeje prej 180 muajsh”.*
37. Komisioni ka konstatuar se në dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit bashkë me deklaratën *vetting*, pasuria objekt shqyrtimi figuron e regjistruar në emrin e Lazër Sallaku dhe A. S., ndërsa në dokumentacionin e depozituar nga AShK-ja<sup>15</sup>, pasuria rezulton e regjistruar vetëm në emrin e subjektit. Ky ndryshim i pronësisë, sipas konstatimit të Komisionit, ka ardhur si pasojë e divorcit<sup>16</sup> dhe dakordësisë së shprehur në marrëveshjen<sup>17</sup> e pjesëtimit të pasurisë, midis subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes A. S..
38. Në analizë të deklarimeve të subjektit, si dhe shpjegimet<sup>18</sup> e dhëna prej tij në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, por edhe me dokumentacionin e administruar, trupi

<sup>15</sup> Referuar informacionit të dhënë nga AShK/Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.11.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>16</sup> Vendim nr. {\*\*\*}, datë 30.06.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për zgjidhje martesë, depozituar nga subjekti me pyetësin e datës 22.07.2020.

<sup>17</sup> Marrëveshje për ndarje pasurie dhe regjimi pasuror nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.10.2017. Sipas marrëveshjes së divorcit është dakordësuar mes palëve që pasuria apartament + garazh të kalojë në emër të subjektit të rivlerësimit me kushtin që ai do të duhet ti paguaj ish-bashkëshortes, A. S., shumën 45.000 euro.

<sup>18</sup> Në shpjegimet e rezultateve të hetimit administrativ subjekti ka sqaruar se: *“Kjo shumë është përdorur nga ish-bashkëshortja ime për të paguar me këste blerjen e apartamentit, sipas faturave që ju kemi vënë në dispozicion, raporti im me këtë pasuri ka qenë si bashkëshorti i blerëses gjatë martesës dhe një këst gjatë bashkëjetesës. Më pas, pasi ish-bashkëshortja ish-bashkëjetuese, në vitin 2017 ka vendosur ta ndërpresë bashkëjetesën me mua dhe të marrohet me një person tjetër, i cili jetonte në Itali dhe kjo donte të jetonte atje me të, me të cilin ka bërë edhe dy fëmijë të tjerë, më kërkoi lekët e shtëpisë se donte të largohej, dhe unë jam detyruar dhe i kam dhënë paratë e saj, praktikisht, ja kam blerë shtëpinë asaj, sipas shpjegimeve që ju kam dhënë në deklaratat e mija përkatëse. Shtëpinë ja kam blerë aq sa ajo e ka pasur blerë, me paratë që kam marrë kredi prej 35.000 euro, pikërisht për këtë blerje dhe me një borxh prej 10.000 euro nga një kushëriri im, siç ju kam informuar në të gjitha deklaratat e mija më parë. Kuptohet që marrëveshja nuk ka qenë e lehtë, por më në fund i dhamë zgjidhje situatës në këtë mënyrë. Nëse ajo nuk do të kishte paguar dhe blerë shtëpinë, unë nuk kisha pse t'i paguaja asaj 45.000 euro për t'i blerë shtëpinë e blerë nga ajo me lekët e nënës së saj, pasi pasuria bashkëshortore është mbi bazën e kontributit*

grykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij kanë pranuar që në fillim të krijimit të pasurisë apartament dhe garazh që ta regjistrojnë atë në pjesë të barabarta 50% me 50%. Për sa i përket marrëveshjes për ndarje pasurie dhe regjimi pasuror për zgjidhje martesë me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.10.2017, trupi gjyqës vlerëson se ka qenë zgjedhja e lirë ndërmjet palëve, nëpërmjet marrëveshjes së tyre që kjo pasuri të mbahej nga subjekti i rivlerësimit kundrejt pagesës në shumën prej 45.000 (dyzet e pesë mijë) eurosh, dhënë ish-bashkëshortes A. S., në vitin 2017. Për rrjedhojë, kjo zgjedhje e tyre për ndarjen e pasurisë nuk afekton kontrollin e pasurisë në këtë proces, për më tepër që marrëveshja për ndarje pasurie është bërë pas dorëzimit të deklaratës *vetting*.

39. Në përfundim të analizimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjyqës vlerëson se veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij mbi pasurinë apartament dhe garazh tregojnë se është një pasuri e krijuar gjatë martesës, pavarësisht se sa ka qenë kontributi i secilit bashkëshort për krijimin e saj.
40. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se nuk ka bërë përpjekje për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar nga nëna e ish-bashkëshortes kësaj të fundit, pasi ka provuar se këtë shumë ish-vjehrra e ka pasur në bankë, shumë kohë para se të njihej me të, duke hequr dyshimin se këto para mund të kishin qenë të tijat dhe të ishin kaluar në llogari të ish-vjehrrës. Sipas subjektit, përveç mandatit bankar ku ish-vjehrra e tij ka tërhequr shumën prej 46.200 eurosh në vitin 2004, gjatë hetimit administrativ në Komision janë administruar disa prova<sup>19</sup> të tjera që vërtetojnë burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar.
41. Lidhur me burimin e krijimit të pasurive objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting të ardhurat nga paga; të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese; dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj; pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga babai i saj*.
42. Trupi gjyqës konstaton se Komisioni ka marrë në analizë të gjitha burimet e financimit të kësaj pasurie, të deklaruara prej subjektit në deklaratën *vetting* dhe nuk gjeti problematika sa i përket të ardhurave nga paga të subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortes së tij, pasi ata kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore dhe të ardhurat e tyre janë konfirmuar që përmbushin

---

*dhe nëse ajo nuk i kishte paguar ato para, nuk kishte si ti merrte mbrapsht. Pra, të gjitha këto tregojnë se nëna e ish-gruas sime e ka disponuar atë shumë dhe ja ka dhënë vajzës së saj, siç e shpjegova. Së bashku me shtëpinë kemi marrë dhe mbajtur edhe nënën e ish-bashkëshortes sime, pasi ajo ka jetuar me ne, sapo jemi martuar e deri sa është larguar në Itali me bashkëshortin tjetër, ku ka vazhduar të jetojë më të, deri sa ka ndërruar jetë pikërisht në Itali, para disa muajsh”.*

<sup>19</sup> *Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.03.2013, ku deklarohet nga nëna e ish-bashkëshortes, shtetasja M. A. se shtetasen A. S. e ka vajzë dhe me rastin e martesës së saj i ka dhuruar një shumë prej 40.000 euro. Këtë shumë ja ka bërë dhuratë dhe se kjo është dhuratë e përvokueshme.*

*Korrespondenca e Komisionit me OTP Bank (e cila e ka përthithur Alpha Bank), nga ku rezultoi se shtetasja M. Xh. S. (A.) më datë 10.02.2004 ka përfutur me dy transferta shumë 86.200 euro (26.200 euro dhe 60.000 euro), me përshkrim “kalim nga M. M. i L. për blerje apartamenti”. Në vijim rezultoi se znj. S. ka tërhequr më datë 12.02.2004 shumë 46.200 euro dhe në muajt në vijim deri në dhjetor 2004 ka tërhequr edhe pjesën tjetër prej rreth 40.000 euro.*

kërkesat e pikës 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës, gjithashtu, Komisioni nuk ngriti dyshime në lidhje me pjesën e trashëgimisë së ish-bashkëshortes bashkëjetuese përfituar nga babai i saj, për sa kohë që pasuria ishte regjistruar në emër të blerësve dhe ishte paguar tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie. Për dhuratën e bërë ndaj ish-bashkëshortes nga nëna e saj në shumën 40.000 euro, Komisioni ka vlerësuar se nuk është provuar ligjshmëria e burimit të krijimit të kësaj pasurie, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, nuk e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare.

43. Në analizë të shkaqeve të ankimit të subjektit lidhur me provimin me dokumentacion dhe njohjen e këtij burimi, sipas së cilit kundërshtohet si i padrejtë qëndrimi i Komisionit, Kolegji mori në shqyrtim të gjitha faktet që rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, nga të cilat konstatohet sa vijon.

43.1. Në deklaratën periodike të vitit 2012, në rubrikën *“Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”*, subjekti e ka deklaruar shumën 40.000 euro si të dhuruar bashkëshortes nga nëna e saj me rastin e martesës (datë 05.06.2012), me pjesë 50%. Në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* apo në llogari bankare. Në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në Selitë, Tiranë, nga *gjendja cash*.

43.2. Në procesverbalin e mbajtur më datë 14.10.2014, në ILDKPKI, në përgjigje të pyetjes nr.7, subjekti ka deklaruar për burimin e shumës 40.000 euro se: *“Në dijeninë time, burimi i kësaj shume janë nga pjesa e dhënë nga vëllezërit e saj nga pronat të cilat i kanë pasur në qytetin e Durrësit. Po ju paraqes një mandatpagesë të “Alpha Bank”, datë 12.02.2004, në të cilën saktësohet tërheqja e bërë nga M. S. (nëna e bashkëshortes) e shumës prej 46.200 eurosh. Nuk disponon dokumentacion lidhur me pasuritë e shitura në Durrës”*.

43.3. Komisioni e ka pyetur subjektin në lidhje me mundësinë e krijimit të shumës së dhuruar dhe njëkohësisht i ka kërkuar të depozitojë dokumentacion justifikues. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 27.03.2023, ka deklaruar se *kjo shumë është dhuruar nga nëna e ish-bashkëshortes së tij, e cila e ka disponuar atë shumë kohë përpara martesës me vajzën e saj dhe shumë kohë përpara se subjekti të kishte lidhje me të. Ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 3, datë 19.04.2023, subjekti ka sqaruar se nuk ka komunikim me ish-bashkëshorten e tij, pasi ajo ka krijuar një familje tjetër, jeton në Itali atje ku dhe nëna e saj ka ndërruar jetë. Ai ka vendosur në dispozicion të Komisionit numrin personal të ID-së së të ndjerës, me qëllim kryerjen e verifikimeve nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision: deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.3.2013, nga ish-vjehrra M. A., e cila deklaroi se i dhuron shumën 40.000 euro vajzës së saj A. S. me rastin e martesës; si dhe mandatpagesën nga “Alpha Bank”, ku pasqyrohet se nëna e ish-bashkëshortes znj. M. S. (A.) në vitin 2004 ka tërhequr shumën prej 46.200 eurosh. Aktet e sipërcituara janë dorëzuar nga subjekti, për herë të parë gjatë periudhës që ka dhënë shpjegime në ILDKPKI, në funksion të kontrollit të pasurisë ushtruar nga ky organ, ndërsa në kuadër të procesit të rivlerësimit rezultoi se subjekti ka dorëzuar të njëjtat dokumente në Komision.*

43.4. Në kthim përgjigjen<sup>20</sup> e noterit L. D. drejtuar Komisionit rezulton se ndodhet vetëm deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.3.2013, e ish-vjehrrës së subjektit, mbi dhurimin dhe nuk gjendet bashkëlidhur mandatpagesa bankare, të cilën subjekti e kishte dorëzuar më parë në ILDKPKI. Trupi gjykues vëren se martesë midis subjektit dhe ish-bashkëshortes A. S. është lidhur më datë 05.06.2012, ndërsa deklarata noteriale e ish- vjehrrës M. A., mbi dhurimin e shumës 40.000 euro vajzës së saj A. S. me argumentin *me rastin e martesës*, është hartuar shumë kohë pas lidhjes së martesës më datë 20.03.2013. Trupi gjykues krijon dyshimin se deklarata noteriale për dhurimin e shumës mund të jetë hartuar në funksion të deklarimit periodik për justifikimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit, pasi vetëm disa ditë më pas (më datë 26.3.2013) ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e interesave periodike të vitit 2012.

44. Nga të dhënat e mësipërme trupi gjykues konstaton se dokumentacioni i mësipërm është i pamjaftueshëm dhe jobindës për të vërtetuar ekzistencën e shumës së dhuruar 40.000 euro, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Vetëm fakti se ish-vjehrra e tij në vitin 2004 ka tërhequr në bankë, 8 (tetë) vite para dhurimit të shumës, një sasi të konsiderueshme në monedhën euro, jo vetëm që nuk provon ekzistencën dhe ruajtjen/mbajtjen e kësaj shume për tetë vite në banesë, por nuk vërteton edhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj. Gjithashtu, duket i pabesueshëm pretendimi i subjektit për dhurimin e shumës nga ish-vjehrra e tij *me rastin e martesës*, pas tetë viteve (nga viti 2004 deri në vitin 2012), kur nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se në vitin 2006 znj. A. S. (ish-bashkëshortja e subjektit) ka pasur një martesë tjetër deri në vitin 2010, vit në të cilin dhe është divorcuar.
45. Megjithëse subjekti i rivlerësimit ka pasur gjithë kohën e mjaftueshme për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar prej 40.000 eurosh në vitin 2012, nuk rezulton të ketë bërë përpjekje gjatë procesit të rivlerësimit të tij për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar. Trupi gjykues çmon se qëndrimet e subjektit në përgjigje të pyetësorëve, por edhe në seancën dëgjimore, si dhe në ankim mbi pamundësinë për gjetjen e dokumentacionit, për shkak të divorcit apo rrethanave të tjera, nuk mund të merren në konsideratë, vlerësuar kjo në raport me faktet e ndodhura, kohën dhe ligjin e zbatueshëm. Në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, subjekti, ashtu siç ka deklaruar<sup>21</sup> në përgjigje të pyetësorit standard, vijonte të bashkëjetonte me shtetasen A. S., pavarësisht divorcit, rrethanë kjo që tregon se subjekti ka pasur mundësinë për të pasur informacion dhe siguruar dokumentacion të plotë nga ish-bashkëshortja bashkëjetuese, për të provuar burimin e ligjshëm për shumën e dhuruar.
46. Subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për gjetjen dhe dorëzimin e dokumentacionit lidhur me shumën e marrë dhuratë edhe në zbatim të udhëzimit të ILDKPKI-së nr. 4095, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016”. Referuar

<sup>20</sup> Kthim përgjigje e noterit L. D. nr. {\*\*\*}, regjistruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 28.04.2023.

<sup>21</sup> Në përgjigje të pyetësorit standard, datë 27.10.2022, subjekti ka deklaruar se: “Pas divorcit kemi vazhduar të bashkëjetojmë [...] dhe kjo bashkëjetesë ka vazhduar deri më datë 24.10.2017, kur ka përfunduar bashkëjetesa për ndarje pasurie dhe regjimi pasuror [...]”.



pikës 19 të këtij akti, udhëzohej që: “[...] nëse personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit deklarojnë një marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur në cilësinë e dhuruesit [...] etj., detyrohen të paraqesin dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit të dhurimit, [...] dhënë personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit [...]”.

47. Në përfundim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte me dokumentacion justifikues ligjor, ligjshmërinë e shumës së dhuruar nga nëna e ish-bashkëshortes së tij, për rrjedhojë pretendimi i subjektit është i pabazuar në fakte dhe prova.
48. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar konstatimin e Komisionit mbi mosprovueshmërinë e burimit të ligjshëm të shumës së dhuruar, si rezultat i konstatimit të ASHK-së se nuk u konfirmuan pasuri në emër e llogari të ish-vjehrrës së tij. Subjekti pretendon se fakti që ASHK-ja nuk përcakton periudhën kohore të kërkimit të këtyre pasurie e bën të parëndësishëm provueshmërinë në rastin konkret.

48.1. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të pavërtetë konkluzionin e Komisionit se pas tërheqjes së shumës 46.200 euro nga znj. M. A. (ish-vjehrra) është investuar në blerjen e një pasurie pasi: bëhet fjalë për një transaksion të bërë në vitin 2018, pra, pas vitit 2012, kur ish-vjehrra ka disponuar shumën 40.000 euro, të cilën ia ka dhuruar vajzës së saj; apartamenti i blerë nga nëna e ish-bashkëshortes së tij nuk është blerë nga shuma 40.000 euro e tërhequr më herët në bankë, por është blerë nga vajza e madhe e saj, znj. E. S., me “Kontratë shitje paraprake”, datë 17.11.2006, në vlerën 26.500 euro dhe 47.000 lekë, i blerë nga paratë që nëna e saj, e ndjera M. A., i ka kaluar sipas transaksionit të realizuar më datë 01.11.2006, në shumën prej 3.450.000. lekësh, me numër llogarie {\*\*\*}.

49. Me qëllim verifikimin e origjinës dhe mundësisë financiare të ish-vjehrrës së subjektit për krijimin e shumës së dhuruar, si dhe evidentimin e mundësisë për të mbajtur të disponueshme shumën 40.000 euro për 8 (tetë) vite radhazi, trupi gjykues mori në analizë veprimet e kryera nga Komisioni për identifikimin e pasurive apo llogarive në emër të znj. M. S. (A.), nga ku rezultoi se Komisioni ka hetuar mbi disa të dhëna të administruara të konfirmuara nga bankat, Regjistri i Noterëve të Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

49.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga ASHK/Drejtoria vendore<sup>22</sup>, rezultoi se në emër të shtetasës M. S. nuk figurojnë pasuri në pronësi/bashkëpronësi, tjetërsime nga dhe te të tretët. Duke marrë në konsideratë faktin se në përgjigje të shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI më datë 14.10.2014 subjekti është shprehur se *në dijeninë time, burimi i kësaj shume janë nga pjesa e dhënë nga vëllezërit e saj nga pronat të cilat i kanë pasur në qytetin e Durrësit, u kontrollua dhe u verifikua dokumentacioni*<sup>23</sup> i ardhur nga ASHK-ja Durrës, sipas së cilit rezultoi

<sup>22</sup> Kthim përgjigje nga ASHK-të Vendore, Durrës, Vlorë, Tirana Jug dhe Tirana Veri.

<sup>23</sup> Kthim përgjigje e ASHK-së Durrës drejtuar Komisionit me e-mail-in e datës 03.05.2023, në të cilën citohet se: *Në lidhje me informacionin e kërkuar pranë drejtorisë vendore ASHK Durrës për shtetasen M. Xh. S., datëlindje 16.06.1946, mjet identifikimi nr. {\*\*\*}, ju bëjmë me dije se: “Nga verifikimi i kryer në sistemin multifunksional, në bazën e të dhënave të vetëdeklarimeve, në sistemin dixhital të legalizimit, si dhe në sistemin elektronik ku*

se nuk gjenden pasuri të paluajtshme në pronësi /bashkëpronësi të znj. M. Xh. S.; 2. Nuk rezultojnë të tjetërsuara pasuri të paluajtshme nga znj. M. Xh. S. te persona të tretë; 3. Nuk rezultojnë të tjetërsuara pasuri të paluajtshme nga persona të tretë te znj. M. Xh. S..

**49.2.** Nga informacioni i marrë nga bankat rezulton se OTP Bank<sup>24</sup> (e cila ka përthithur Alpha Bank) ka informuar Komisionin se ish-vjehrra e subjektit, znj. M. Xh. S. (A.), më datë 10.02.2004 ka përfituar me dy transferta shumën 86.200 euro (26.200 euro dhe 60.000 euro), me përshkrim “*Kalim nga M. M. i L. për blerje apartamenti*”. Në vijim rezulton se znj. S. ka tërhequr më datë 12.02.2004 shumën 46.200 euro dhe në muajt në vijim deri në dhjetor 2004 ka tërhequr edhe pjesën tjetër prej rreth 40.000 euro.

**49.3.** Nga faktet e paraqitura më lart, trupi gjykues vëren se nuk provohet me dokumentacion ligjor fakti se ish-vjehrra e subjektit të ketë disponuar pasuri, të cilat mund t’i ketë shitur më pas dhe me një pjesë të të ardhurave të përfituara t’i ketë dhuruar pas tetë viteve subjektit shumën prej 40.000 eurosh. Pavarësisht pretendimit të subjektit apo edhe faktit se informacioni i përcjellë nga ASHK-ja Vendore mund të përmbajë të dhëna të paplota, si rezultat i mosinformatizimit të të gjithë dokumentacionit arkivor, trupi gjykues rithekson se barrën e provës në këtë proces rivlerësimi e ka subjekti i rivlerësimit, bazuar në pikën 5, të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe pikën 2, të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Rezulton se subjekti nuk ka bërë asnjë përpjekje të disponojë dokumentacionin e kërkuar, përgjatë hetimit administrativ në Komision, edhe në kohën kur ka qenë në martesë dhe bashkëjetonte, madje edhe me ish-vjehrrën e tij.

**50.** Gjithashtu, në lidhje me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar nga korrespondenca e Komisionit, mbajtur me noterin publik<sup>25</sup>, nga ku rezultoi se:

**50.1.** Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.04.2023, noteri publik A. F. i ka përcjellë Komisionit “Kontratë shitjeje paraprake” të datës 17.11.2006, sipas së cilës rezulton se motra e ish-bashkëshortes E. S. ka blerë një apartament në vlerat 26.500 euro dhe 47.000 lekë, nga shitësi “{\*\*\*}” (bashkëlidhur mandatpagesat). Me anë të “Kontratë shitjeje paraprake” (zëvendësim i palës blerëse), me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.04.2017, është bërë zëvendësimi i palës blerëse nga E. S. në M. A., si palë në këtë kontratë, pikërisht për apartamentin {\*\*\*} (kati {\*\*\*} nga toka), godina nr. {\*\*\*}, ish-fusha e aviacionit, kundrejt çmimit 26.500 euro.

---

*pasqyrohen lejet, ka rezultuar se: 1. Nuk gjenden pasuri të paluajtshme në pronësi /bashkëpronësi të znj. M. Xh. S. ; 2. Nuk rezultojnë të tjetërsuara pasuri të paluajtshme nga znj. M. Xh. S. te persona të tretë; 3. Nuk rezultojnë të tjetërsuara pasuri të paluajtshme nga persona të tretë te znj. M. Xh. S. 4. Nuk figuron aplikuese në procesin e legalizimit në emër të znj. M. Xh. S.; 5. Nuk figuron e pajisur me leje legalizimi apo skualifikim znj. M. Xh. S.. Kujtesë: Sistemet e lartpërmendura të kontrollit nuk përmbajnë të informatizuar tërësisht informacionin që i referohet dokumentacionit të arkivuar në të gjitha zonat kadastrale përkatëse pranë DV ASHK DURRËS. Sa më sipër, informacioni i përcjellë nga ana jonë, garanton saktësinë vetëm për pasuritë e regjistruara në sistem dhe jo për pasuri që nuk janë të hedhura në sistem.*

*Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 09.05.2023, e ASHK-së Drejtoria Durrës.*

<sup>24</sup> *Kthim përgjigje nga OTP, shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 20.04.2023.*

<sup>25</sup> *Mbi të dhënat e konfirmuara nga Regjistri Noterëve Shqiptarë, administruar në dosjen e Komisionit, noteri publik ka depozituar aktin me shkresën datë 25.04.2023, administruar në dosjen e Komisionit.*

50.2. Me praktikën noteriale<sup>26</sup> të noterit publik E. M., u administrua nga Komisioni kontratë shitje nr. {\*\*\*}, datë 02.05.2018, e nënshkruar midis znj. M. A. (nënës së znj. A. S., ish-vjehrra e subjektit) dhe shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}”, sipas së cilës znj. A. ka blerë apartamentin<sup>27</sup> me sipërfaqe 43 m<sup>2</sup>. Në nenin 3 të kontratës së shitjes cilësohet se blerësi e ka likuiduar totalisht shumën 3.000.000 lekë që në datën 30.12.2005, fakt që vërtetohet edhe nga deklarata noteriale nr. {\*\*\*}, datë 02.05.2018, mbajtur midis shitësit dhe blerësit për likuidimin e shumës. Bashkëlidhur kontratës janë mandatarkëtimet për shlyerjen e pagesave për këtë pasuri, të cilat datojnë më 17.11.2006, 27.06.2007 dhe 17.08.2007 dhe përkatësisht pasqyrojnë pagesat e kryera në shumat, 20.000 euro, 6.000 euro dhe 500 euro.

51. Trupi gjykues, në vijim të analizës për verifikimin e mundësisë financiare të ish-vjehrrës së subjektit të rivlerësimit për dhurimin e shumës prej 40.000 eurosh, referuar akteve të mësipërme konstaton se në kontratën e shitjes paraprake (zëvendësim i palës blerëse) të vitit 2017, motra e ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj E. S., deklaroi se [...] *jam dakort që të zëvendësohem si palë blerëse në kontratën e shitblerjes përfundimtare nga nëna ime M. A., e cila faktikisht ka likuiduar pagesat për blerjen e këtij apartamenti [...]*. Nisur nga fakti se ish-vjehrra e subjektit ka kryer pagesat për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 43 m<sup>2</sup>, por edhe nënshkrimi i kontratës së shitjes për këtë apartament në vitin 2018 nga znj. M. A. (S.) në cilësinë e blerëses, si dhe hapja e kontratës së shërbimit me energji elektrike në datën 15.10.2007, nga M. A., të çojnë në konkluzionin se ish -vjehrra e subjektit pas tërheqjes së shumës 46.200 euro ka shpenzuar një pjesë të shumës të tërhequr në bankë në vitin 2004, duke u investuar në blerjen e një pasurie.
52. Në përfundim, për pasuritë apartament me sip. 86,30 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 22,9 m<sup>2</sup>, të ndodhura në kompleksin rezidencial “{\*\*\*}”, në Selitë, Tiranë, Kolegji, pasi analizoi shkaqet e ankimit në konsideratë të të gjitha të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ dhe kontrolloi qëndrimet e Komisionit lidhur me to, arriti në konkluzionet e mëposhtme.

i) Subjekti nuk paraqiti ndonjë të dhënë apo dokument të ri gjatë procesit të rivlerësimit në Komision për identifikimin e pronësisë/ve, tjetërsimin e tyre, për përcaktimin e pjesës takuese të dhurueses, ish-vjehrrës M. S., që do të shërbenin për të provuar mundësinë e saj.

ii) Lidhur me shumën prej 40.000 eurosh, deklaruar *dhuratë me rastin e martesës* për ish-bashkëshorten bashkëjetuese nga nëna e saj në vitin 2012, e cilësuar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2012 në pjesë takuese 50% dhe që ka shërbyer si një nga burimet për krijimin e pasurive të sipërcituara, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, vendosi të mos marrë në konsideratë shumën prej 40.000 eurosh, si të ardhur në vitin 2012, pasi nuk u provua me dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i të ardhurave të nënës së ish-bashkëshortes si person tjetër i lidhur, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

<sup>26</sup> Kthim përgjigje shkresës së Komisionit nr. {\*\*\*} prot., datë 24.04.2023, për noterin publik E. M..

<sup>27</sup> Apartament me sip. 43 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie {\*\*\*}, ndodhur në z. k. {\*\*\*}, sipas certifikatës nr. {\*\*\*}, datë 24.01.2018.

iii) Në analizë dhe në vlerësim të të gjithë aspekteve që rezultuan nga aktet në fashikull, subjekti nuk krijon qartësi dhe besueshmëri me deklaratimet e tij, duke pamundësuar kështu edhe verifikimin e mundësisë reale për disponimin e shumës së dhuruar pas 8 vitesh, nga tërheqja në bankë dhe deri në përdorimin e saj, për krijimin e pasurive të mësipërme.

53. Për shkak të këtij konkluzioni, Kolegji gjeti të drejtë analizën financiare të kryer nga Komisioni për verifikimin e mundësisë për krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme, ku si pasojë e mosmarrjes në konsideratë të shumës 40.000 euro, dhuruar bashkëshortes, pasi nuk provohej burimi i ligjshëm i krijimit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit rezultonte në pamundësi financiare në shumën prej (-) 4.857.593 lekësh në vitin 2012, pasi ai dhe bashkëshortja (në atë kohë) nuk kanë pasur mundësi të kenë gjendje *cash* shumën prej 40.000 eurosh, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

54. Lidhur me burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, të përdorura nga gjendja e likuiditetit *cash* për pagesat e kryera për blerjen e pasurive apartament me sip. 86,30 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 22,9 m<sup>2</sup>, të ndodhura në kompleksin rezidencial “{\*\*\*}”, në Selitë, Tiranë, trupi gjykues verifikoi deklaratimet e subjektit ndër vite, mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar dhe analizoi pretendimet e subjektit të ngritura mbi analizën e kryer në Komision, duke marrë në shqyrtim çdo pretendim, sipas këndvështrimit të parashtruar në ankim e duke vlerësuar rezultatin që del nga këto analiza nga ku rezulton se:

54.1. Në deklaratën periodike vjetore 2010, në rubrikën “*Ndryshimet e interesave private të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme*”, subjekti ka deklaruar: “*Kursime familjare monetare. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 100%*”.

Në deklaratën periodike vjetore 2011, subjekti ka deklaruar: “*Kursime familjare monetare. Vlera: 200.000 lekë. Pjesa takuese: 100%*”.

54.2. Në deklaratën periodike vjetore 2014, subjekti deklaron: “*Pakësim i gjendjes cash nga pagimi i dy kësteve për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK për ndërtimin e një apartamenti me adresë Komuna Farkë, Rezidenca {\*\*\*}, në objektin {\*\*\*}, Rruga {\*\*\*}, apartamenti nr. {\*\*\*}, me sip. ndërtimore 100,7 m<sup>2</sup>, përfshirë sip. e përbashkët 2+1. Kësti i parë 10.000 euro, parapaguar për rezervim më datë 06.02.2014 dhe kësti dytë 20.727 euro, paguar me nënshkrimin e kontratës më datë 24.12.2014, marrëveshje e lidhur me kontratën e sipërmarrjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2014. Vlera: 30.727 euro. Pjesa në %: 100%. Burimi: nga gjendja cash”.*

54.3. Në deklaratën periodike vjetore 2016, subjekti deklaron: “*Pakësim i gjendjes cash 15.596 euro, paguar më datë 09.06.2016 dhe lidhur kontrata e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.10.2016, për apartamentin me nr. {\*\*\*}, i ndodhur në Selitë, Tiranë, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, z. k. {\*\*\*}, v. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}, me sip. fizike 86,3 m<sup>2</sup>, sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë më datë 08.11.2016. Vlera: 15.596 euro. Pjesa në %: 50%. Burimi: nga gjendja cash e kursyer nga të ardhurat nga paga; të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese; dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes*

*bashkëjetuese nga nëna e saj; pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortja bashkëjetuese nga babai i saj”.*

**54.4.** Në deklaratën periodike vjetore 2016, subjekti deklaron: *“Pakësuar gjendja cash me pagimin e 7.547 eurove, parapaguar më datë 13.10.2016, me kontratë premtim shitje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.10.2016, e garazh nr. {\*\*\*}, me sip. 22,9 m<sup>2</sup> në Kompleksin Rezidencial {\*\*\*}, në Selitë, Njësia Administrative Farkë, Tiranë, me nr. pasurie. {\*\*\*}, regjistruar në z. k. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}. Vlera: 7.547 euro. Pjesa në %: 50%. Burimi: nga gjendja cash e kursyer nga të ardhurat nga paga; të ardhurat nga paga e ish-bashkëshortes bashkëjetuese; dhurata e bërë ndaj ish-bashkëshortes bashkëjetuese nga nëna e saj; pjesa e trashëgimisë së ish-bashkëshortja bashkëjetuese nga babai i saj”.*

55. Trupit gjykues i rezultoi se në analizën financiare të kryer në Komision subjekti rezultoi me balancë negative prej (-) 167.503 lekësh në vitin 2010, si dhe prej (-) 1.122.332 lekësh në vitin 2011, pasi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi” dhe mjetit detar “Skaf” nuk i ka pasqyruar si gjendje *cash*, në vitet pasardhëse. Për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar ato si gjendje *cash*, Komisioni në vendim, duke referuar jurisprudencën e Kolegjit, ka konkluduar për të njëjtat diferenca negative si në raportin e rezultateve hetimore.
56. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka paraqitur të njëjtat pretendime, ashtu si dhe në parashtrimet e dorëzuara në seancën dëgjimore në Komision, duke argumentuar se balancat negative të vitit 2010 dhe 2011 janë rrjedhojë e mosllogaritjes së shumave të përfituara nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi”, në shumën 500.000 lekë, si dhe të mjetit detar, skaf i vogël, “sanall gjuetie”, në vlerën 180.000 lekë, në vitin 2009, shuma këto që, sipas tij, kanë qënë gjendje *cash*, por si pasojë e një pakujdesie nga ana e tij nuk janë deklaruar si të tilla.
57. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, nga aktet e administruara në fashikull, konstatoi se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Mitsubishi Pajero”, më datë 15.08.2009, në vlerën 500.000 lekë, ka deklaruar shitjen e motoskafit “sanall gjuetie”, më datë 04.07.2009, në vlerën 180.000 lekë. Gjithashtu ka deklaruar blerjen e autoveturës tip “Volkswagen Golf”, më datë 14.04.2009, në vlerën 5.800 euro, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Nuk ka deklaruar likuiditete *cash*, si dhe nuk ka deklaruar kredinë në “Raiffeisen Bank” marrë më 14.04.2009 prej 900.000 lekësh nga bashkëshortja në atë kohë A. M. (ish-bashkëshortja divorcuar në vitin 2010).
58. Si subjekt deklarimi për efekt dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë në ILDKPKI, në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë, çdo ndryshim të ndodhur të interesave privatë të vitit respektiv. Në përshkrimin e seksionit “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, në deklaratën e interesave privatë periodikë kërkohet nga deklaruesit: *Përshkruani hollësisht ndryshimet (shitesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të*

*dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni, të çdo lloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit.*

Kjo rubrikë e deklaratës detajon detyrimin për zbatim të nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003, që parashikon: [...] *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...].*

59. Në një vlerësim të mënyrës së plotësimit prej subjektit të deklarimeve periodike, trupi gjykues vëren se dhe pse në DPV-në 2009 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si gjendje *cash* të pretenduar nga të ardhurat nga shitja e automjetit “Mitsubishi Pajero” dhe e motoskafit “sanall gjuetie”, subjekti nuk e ka korrigjuar deklarimin e tij për të deklaruar likuiditetin *cash* të pa deklaruar në vitin 2009 [nga shitja e automjetit “Mitsubishi Pajero” dhe e motoskafit “sanall gjuetie”], në vitin 2010, por ka deklaruar në këtë vit likuiditetin *cash* prej 500.000 lekësh. Gjithashtu, të njëjtin veprim, subjekti ka bërë dhe në deklarimin e vitit 2011, duke deklaruar likuiditet *cash* shtesë prej 200.000 lekësh, pra, deklarimet e tij në vitet në vijim e bëjnë të pabesueshëm pretendimin e subjektit se ka pasur likuiditet *cash* në vitin 2009 dhe e ka mbartur deri në vitin 2011, kur është mbyllur kredia konsumatore në Raiffeisen Bank.
60. Për rrjedhojë, trupi gjykues e konsideron të drejtë qëndrimin e Komisionit për llogaritjen e të ardhurave nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi Pajero” dhe e motoskafit “sanall gjuetie” në analizën e vitin 2009 dhe mospërfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën e viteve 2010 dhe 2011, për sa kohë subjekti nuk i ka deklaruar këto shuma si gjendje *cash* në deklaratat periodike të viteve 2010 dhe 2011, në përputhje kjo edhe me jurisprudencën e Kolegjit.
61. Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit dhe akteve të administruara vlerëson se pretendimi i subjektit *se nuk e ka ditur faktin se kredia konsumatore e marrë nga ish-bashkëshortja A. S. në vitin 2009 nuk ishte mbyllur që në vitin 2009, pasi ai ia kishte dhënë ish-bashkëshortes paratë e shitjes të automjeteve për ta mbyllur atë kredi*<sup>28</sup>, nuk qëndron, vlerësuar kjo me rrethanat dhe situatën faktike të mëposhtme.

61.1. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.09.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka informuar Komisionin se Lazër Sallaku ka pasur në pronësi automjetin tip “Volkswagen Golf”, me targë {\*\*\*}. Kjo drejtori ka depozituar kontratën e shitblerjes së automjetit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol, datë 14.04.2009, me palë shitëse shtetasin E. D. dhe palë blerëse shtetasin Lazër Sallaku, blerë në vlerën 5.800 euro.

---

<sup>28</sup> *Subjekti i rivlerësimit e mbështet pretendimin e tij nëpërmjet deklarimeve që ka dhënë në ILDKPKI më datë 14.10.2014, si dhe deklaratës noteriale të ish-bashkëshortes A. M., datë 23.05.2023, e cila konfirmon thëniet e subjektit Lazër Sallaku.*

**61.2.** Në pyetëtorin standard, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për blerjen e këtij mjeti ka shërbyer kredia konsumatore e marrë nga ish-bashkëshortja, shtetasja A. M. (S.), në Raiffeisen Bank, në shumën 900.000 lekë. Për këtë arsye, Komisioni verifikoi procedurën e marrjes deri në likuidimin e plotë të kredisë pranë kësaj banke.

**61.3.** Raiffeisen Bank<sup>29</sup> ka informuar Komisionin se A. A. S. (M.) ka marrë një kredi në shumën 900.000 lekë në datën 14.04.2009 dhe e ka mbyllur atë në datën 17.05.2011. Nga lëvizjet e llogarive bankare në vitin 2011, rezulton se këstet e kredisë janë paguar nga fondet që kanë hyrë në llogari: dy depozitime *cash* nga Lazër Sallaku në vlerën totale 65.000 lekë (në datat 07.01.2011 e 04.02.2011), kalimet e pagave të A. M. dhe më 16.05.2011, kjo e fundit, ka depozituar vlerën 679.000 lekë, duke kryer mbylljen totale të kredisë.

**61.4.** Për kredinë konsumatore të marrë nga ish-bashkëshortja në vitin 2009 dhe shlyerjen e saj, Komisioni ka vlerësuar se pretendimi i subjektit nuk qëndron, pasi në vitin 2009 ai ka qenë ende në martesë ligjore me znj. A. S. (M.) dhe ka plotësuar deklaratën periodike në këtë vit, duke deklaruar të dhëna edhe për znj. M., duke konkluduar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me gjendjen *cash* për vitin 2009.

- 62.** Lidhur me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.05.2023, të ish-bashkëshortes A. M., të paraqitur nga subjekti në seancën dëgjimore në mbështetje të pretendimeve të tij, trupi gjykues vlerëson se deklarata noteriale e kryer vetëm një ditë para zhvillimit të seancës dëgjimore, pas dorëzimit të prapësimeve për rezultatet e hetimit administrativ, ka vlerë të kufizuar për sa i përket provueshmërisë së faktit që kërkon të provojë, duke qenë se është konsideruar si një përpjekje e subjektit, e diktuar nga nevoja për të justifikuar me burime të ligjshme një situatë negative financiare të konstatuar nga hetimi. Deklaratat noteriale të përpiluara për këtë qëllim konsiderohen me vlerë provuese të ulët, sa kohë që ato nuk mbështeten nga të dhëna të tjera që rezultojnë nga dokumentacioni ligjor i krijuar në mënyrë autonome e jashtë ndikimit të procesit të rivlerësimit.
- 63.** Nga verifikimi i deklaratës periodike të vitit 2009, rezulton se subjekti nuk e ka deklaruar kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” nga ish-bashkëshortja e tij, në kuptim e zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë pasurinë, burimin e krijimit, të ardhurat dhe detyrimet financiare të bashkëshortes së tij. Neni 22 i këtij ligji përcakton dhe mënyrën e deklarimit, duke parashikuar se deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklaram. Trupi gjykues, megjithëse e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se deklarimi i subjektit në DPV-në 2009 ka pasaktësi, vlerëson se bazuar në jurisprudencën<sup>30</sup> e Kolegjit pasaktësitë në deklarimet periodike të pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore.

---

<sup>29</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 25.09.2020.

<sup>30</sup> Vendimet nr. 11/2018 (JR) dhe nr. 5/2019 (JR), të Kolegjit.

64. Në aktmarrëveshjen për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok, datë 28.07.2010 (nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., pranë notere M. R. Sh.), ndër të tjera, subjekti dhe ish-bashkëshortja A. M. kanë përcaktuar me marrëveshje mënyrën e ndarjes së pasurive, për automjetin tip “Volkswagen Golf” dhe shlyerjen e kredisë pranë “Raiffeisen Bank” në vlerën prej 900.000 lekësh. Më konkretisht, referuar në pikën 4 të aktmarrëveshjes, palët kanë dhënë dakordësinë e tyre se *me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, kjo kredi do të kthehet në mënyrë periodike nga z. Lazër Sallaku, sipas kushteve të përcaktuara te Kontrata e Kredisë*, duke përcaktuar në mënyrë të qartë detyrimin e subjektit për likuidimin e kredisë së marrë në vitin 2009.

64.1. Sikurse vërehet, akti “marrëveshja për zgjidhjen e martesës”, në të cilën palët kanë detajuar se kujt i përkiste detyrimi i shlyerjes së kredisë në Raiffeisen Bank, është hartuar në datën 28.07.2010, ndërsa subjekti disa kohë përpara, më datë 19.03.2010, ka dorëzuar në ILDKPKI, deklaratën periodike të vitit 2009, duke rrëzuar në këtë mënyrë pretendimin e subjektit për padijeninë e tij për mosshlyerjen e kredisë. Duket se me shpjegimet e tij, vetë subjekti, mbetet konfuz dhe kontradiktor për mënyrën e shlyerjes së kredisë, fakt që e potencon edhe më shumë bindjen e Kolegjit se subjekti ka qenë në dijeni që kredia nuk ishte shlyer dhe se i ka kaluar atij detyrimi i shlyerjes së saj. Pra, nga sa më lartanalizuar, trupi gjykues e vlerëson të drejtë analizën financiare të Komisionit për llogaritjen e gjendjes *cash* në vitet 2010 dhe 2011, për rrjedhojë shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit nuk qëndron.

65. Në përfundim të vlerësimit të këtij shkak i ankimi, lidhur me kursimet e deklaruara në vitet 2010, 2011 e 2012, të përdorura në vijim si burim për krijimin e pasurive apartament dhe garazh, trupi gjykues konfirmon qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare të krijojë këto kursime dhe të përballojë shpenzimet e kryera gjatë viteve. Efekti financiar i këtij arsytimi pasqyrohet në analizën financiare të kryer prej Komisionit e të konfirmuar prej Kolegjit, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare në shumën (-) 167.503 lekë në vitin 2010 dhe në shumën (-) 1.122.332 lekë në vitin 2011 për të krijuar kursimet, si dhe më pas këto kursime t’i investojë në pasuritë apartament dhe garazh.

66. Për rrjedhojë, Kolegji konstatoi se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme që kanë mundësuar krijimin e pasurisë apartament me sip. 86,30 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 22,9 m<sup>2</sup> të ndodhura në kompleksin rezidencial “{\*\*\*}”, në Selitë, Tiranë.

67. Në ankimin e paraqitur në Kolegji, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka paraqitur fakte të pavërteta mbi kohën e përfitimit, kontributin dhe periudhën kohore të posedimit të kësaj pasurie prej tij. Komisioni ka shtrembëruar konkluzionet e ILDKPKI-së, ka paraqitur fakte të pavërteta lidhur me transaksionet, pasuritë dhe dhurimet e kryera nga ish-vjehrra e tij, konkretisht subjekti kundërshton faktet e vendimit të Komisionit si më poshtë.

68. Në vendimin e Komisionit, në pjesën hyrëse të tij, në pikën 13 titulluar A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja, në dy paragrafët e parë citohet se *deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë*, sipas



subjektit këto fakte janë të pavërteta dhe në kundërshtim me përfundimet e arritura nga ILDKPKI-ja në raportin e saj nr. {\*\*\*} prot., datë 28.09.2018, e cila ka konstatuar se *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*

69. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues konstaton se është i drejtë pretendimi i subjektit mbi citimin në mënyrë të gabuar të konkluzioneve të raportit të ILDKPKI-së në vendimin e Komisionit, por në fashikull gjendet vendimi nr. 667/1, datë 26.05.2023, “*Mbi korrigjimin e gabimeve materiale të vendimit nr. 667, datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Lazër Sallaku*”. Trupi gjykues vëren se ky vendim në dispozitivin e tij ka vendosur të rregullojë gabimin material, pikërisht në pjesën hyrëse të tij, në pikën 13 titulluar A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja, 2 paragrafët e parë: *deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë, duke i zëvendësuar me paragrafët: deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
70. Trupi gjykues vëren se vendimi i sipërcituar për korrigjimin e gabimeve materiale të vendimit nr. 667, datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton të jetë marrë më datë 10.07.2023 dhe i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.07.2023. Në përgjigje të këtij shkak ankimi, trupi gjykues çmon se gabimi material i Komisionit, i rregulluar nga vetë ai, nuk ka sjellë ndonjë pasojë që mund të ketë ndikuar në procesin e rivlerësimit të subjektit Lazër Sallaku, për sa kohë vendimmarrja e Komisionit është bazuar në provat dhe faktet e mbledhura gjatë hetimit administrativ, për të cilat subjekti është njohur dhe ka paraqitur kundërshtimet e tij.
71. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit se *nga korrespondenca e Komisionit me ProCredit Bank<sup>31</sup> rezulton se në datën 01.11.2006 shtetasja M. S. ka depozituar shumën 3.450.000 lekë me përshkrimin “të ardhura nga shitja e shtëpisë”, e cila në këtë datë është transferuar dhe nuk provohet përfituesi i kësaj shume, si dhe nuk u provua ndonjë dhurim nga nëna e ish-bashkëshortes në adresë të motrës së kësaj të fundit, pasi nga “Informacion i detajuar për transaksion bankar”, datë.11.05.2023, nga ProCredit Bank, rezulton se përfituesi i transaksionit të realizuar më datë 01.11.2006, në shumën prej 3.450.000.00 lekësh, ka qenë shtetasja E. S. S. (motra e ish-bashkëshortes).*
72. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues, pasi kontrollloi vendimin e Komisionit konstaton se në faqen 9 të tij, Komisioni, pasi ka analizuar transfertën e shumës prej 3.450.000 lekësh të shtetasës M. S. ka cituar frazën *pa u provuar përfituesi i saj*, të cilën subjekti e kundërshton si të pavërtetë. Trupi gjykues vëren se në këtë pjesë të vendimit janë renditur faktet e Komisionit deri në fazën e hetimit administrativ, duke u bazuar pikërisht në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 17.09.2020, të ProCredit Bank. Ndërsa në të njëjtin paragraf, por duke e vendosur në *footnote* me nr. 23, ka sqaruar se *ProCredit Bank, pas dërgimit të rezultateve të*

---

<sup>31</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 17.09.2020.

*hetimit subjektit të rivlerësimit, konfirmoi të dhëna lidhur me përfituesin. Ky konfirmim iu bë me dije edhe subjektit.*

73. Gjithashtu, nga verifikimi i vendimit konstatohet se në pjesën arsyetuese të tij dhe të konkluzioneve për këtë pasuri konkretisht në paragrafin 17.12.1, pika “a”, Komisioni ka konfirmuar përsëri se referuar dokumentit “*Informacion i detajuar për transaksion bankar*”, datë 11.05.2023, nga ProCredit Bank, përfitues i transaksionit të realizuar më datë 01.11.2006, në shumën prej 3.450.000 lekësh, ka qenë shtetasja E. S. S..
74. Nga sa më lart, trupi gjykues çmon se në kushtet kur informacioni për emrin e përfituesit të shumës së transferuar ka ardhur pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe subjekti është njoftuar për informacionin e ri të ardhur, si dhe ky fakt është pasqyruar në vendimin e Komisionit, pretendimi i subjektit konsiderohet i pabazuar.
75. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka gabuar në vendim kur citon se *nuk u provua ndonjë dhurim nga nëna e znj. S. në adresë të motrës së kësaj të fundit/vajzës tjetër, sikurse ishte mundësuar në rastin e ish-bashkëshortes të subjektit, znj. A. S. (dhuruar shuma prej 40.000 euro)*, pasi, sipas subjektit, nga transaksioni bankar, datë 01.11.2006, në shumën prej 3.450.000.00 lekësh, provohet se edhe E. S., vajza e tjetër e nënës së ish- bashkëshortes, ka marrë një shumë parash nga nëna e saj.
76. Trupi gjykues, në vijim të analizimit të këtij shkakui ankimi të subjektit, vëren se pavarësisht se transaksioni bankar, datë 01.11.2006, në shumën prej 3.450.000 lekësh kaluar nga M. A. te vajza tjetër e saj E. S. S., duket si shumë e dhuruar (shumë e cila sipas subjektit ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 43 m<sup>2</sup>, godina nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, me “Kontratë shitjeje paraprake”, datë 17.11.2006), nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikujt e Komisionit nuk rezulton kështu, pasi:
- 76.1. Me “Kontratë shitje paraprake”, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.04.2017 (me të cilën është bërë zëvendësimi i palës blerëse nga E. S, në M. A.), ndërsa me kontratën e shitjes përfundimtare nr. {\*\*\*}, datë 02.05.2018, znj. M. A. (nëna e znj. A. S.) ka blerë apartamentin me sipërfaqe 43 m<sup>2</sup> nga shoqëria ndërtimore “{\*\*\*}”. Nga sa më lart, trupi gjykues çmon se shuma e kaluar nga M. A. te vajza tjetër e saj E. S. me transfertën bankare të vitit 2006, që duket se ka shërbyer për blerjen e apartamentit, pronësinë e të cilit e ka fituar znj. M. A. e, për rrjedhojë, transaksioni i vitit 2006 nuk mund të konsiderohet si dhurim për vajzën tjetër, në kushtet kur përfituesi i fundit i kësaj shume është vetë ish-vjehrra e subjektit, duke përfituar apartamentin me sipërfaqe 43 m<sup>2</sup>. Për sa më lart, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit.
77. Subjekti i rivlerësimit e konsideron fakt të pavërtetë konstatimin e Komisionit *se ai ka poseduar në mënyrë të vazhdueshme këtë pasuri duke nisur që prej vitit 2012*, pasi, ashtu siç ka shpjeguar në pyetësorin standard, për periudhën 02.01.2012 - 31.10.2016, ka jetuar në një apartament tjetër me qera, në ap. nr. {\*\*\*}, Rruga e {\*\*\*} “{\*\*\*}”, Komuna Farkë, Tiranë.

78. Trupi gjykues, megjithëse çmon se problematika mbi posedimin e këtij apartamenti nga subjekti prej vitit 2012 nuk ka peshë në procesin e tij të rivlerësimit, me qëllim dhënien e përgjigjes subjektit për çdo shkak të paraqitur në ankim, verifikoi deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar për këtë çështje nga ku rezulton se:

78.1. Në dokumentin “Kontratë qiraje”, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, paraqitet e njëjta adresë, ashtu sikurse deklaroi subjekti në deklaratat periodike vjetore, si dhe të njëjtën shumë pagimi qiraje në vlerën 200 euro. Kjo kontratë nuk është e firmosur nga qiradhënësi, por është e nënshkruar vetëm nga subjekti i rivlerësimit, nuk ka datë, çka e bën atë një dokument jo të vlefshëm për arsye se nuk është sjellë në formën e kërkuar nga ligji. Libreza e energjisë elektrike me nr. kontrate {\*\*\*} është në emër të abonentit “{\*\*\*}” ShPK.

78.2. Në deklaratat periodike vjetore 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën “*Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*” pagimin e qirasë së shtëpisë me adresë “Ap. nr. {\*\*\*}, Rruga e {\*\*\*}, “{\*\*\*}”, Komuna Farkë, Tiranë”, në vlerën 2.400 euro ose 200 euro në muaj. Ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2016 deklaroi të njëjtën adresë për pagimin e qirasë, por për periudhën 01.01.2016 - 30.09.2016, në vlerën 1.800 euro ose 200 euro në muaj.

78.3. Në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit, lidhur me adresën e apartamentit të cilin e ka blerë dhe jeton aktualisht, deklaroi: “*Pakësim i gjendjes cash nga pagimi i dy kësteve për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK për ndërtimin e një apartamenti me adresë Komuna Farkë, Rezidenca {\*\*\*}, në objektin {\*\*\*}, Rruga e {\*\*\*}, apartamenti nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe ndërtimore 100,7 m<sup>2</sup>*”. Sikurse vërehet nga deklaratimet e subjektit, megjithëse zona ku ka pasur apartamentin në të cilin ka jetuar me qera subjekti është e njëjtë me zonën në të cilën ai ka blerë apartamentin (Komuna Farkë, Rezidenca {\*\*\*}), referuar adresave të deklaruara nga vetë subjekti, duket se apartamentet nuk janë të njëjtë.

78.4. Një fakt tjetër që mbështet këtë konstatim është përcaktimi i adresës së apartamentit në kontratën e sipërmarrje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2014 dhe kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.10.2016, sipas së cilave apartamenti objekt i kontratës është apartamenti nr. {\*\*\*}, me sip. 100,7 m<sup>2</sup>, me adresë Komuna Farkë, Rezidenca “{\*\*\*}”, në objektin {\*\*\*}, Rruga e {\*\*\*}, ndryshe nga adresa e dekluar nga subjekti për apartamentin e marrë me qira (ap. nr. {\*\*\*}, Rruga e {\*\*\*}).

78.5. Gjithashtu, nga verifikimi i kontratës së sipërmarrje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.12.2014, rezulton se në nenin 5 “*Dorëzimi i apartamentit*” citohet se: “*Sipërmarrësi merr përsipër që t’i dorëzojë porositësit apartamentin e përfunduar brenda periudhës kohore 31.07.2016 [...]*”, pra, duket se apartamenti ishte i papërfundur dhe do të dorëzohej nga sipërmarrësi në muajin korrik të vitit 2016.

78.6. Referuar fakteve të mësipërme, por edhe dispozitës së nenit në kontratën e sipërcituar, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka jetuar në periudhën 2012-2016 në të njëjtin apartament me atë të blerë në vitin 2016, ashtu sikurse i ka rezultuar Komisionit. Trupi gjykues vlerëson

se ky fakt i renditur në vendimin e Komisionit ka qenë një konstatim i përgjithshëm, pa peshë përcaktuese në analizën e pasurive, për pasojë edhe pse pretendimi i subjektit është i drejtë, ai rezulton pa efekt për vendimmarrjen e Komisionit dhe të Kolegjit.

79. Për sa më sipër, Kolegji, pasi analizoi shkaqet e parashtruara në ankim, si dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, si dhe pasi analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat dhe aktet e administruara për këtë çështje gjatë hetimit administrativ, arriti në konkluzionin se vendimi nr. 667, datë 26.05.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është një vendim i drejtë, i bazuar në fakte e në ligj, i cili mbështetet në mënyrë të përmbledhur në konkluzionin si më poshtë.
80. Në kushtet që nuk u provua ligjshmëria e burimit të krijimit të pasurisë apartament me sip. 86,30 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 22,9 m<sup>2</sup> të ndodhura në kompleksin rezidencial “{\*\*\*}”, në Selitë, Tiranë, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultojnë në pamundësi financiare për të krijuar gjendjen *cash* në shumën prej 40.000 eurosh, si dhe të përballonin shpenzimet e tjera familjare në shumën prej (-) 4.857.593 lekësh, në vitin 2012. Si rrjedhojë e mosmarrjes në konsideratë edhe të pretendimeve të subjektit sa i takon balancave negative në shumën prej (-) 167.503 lekësh në vitin 2010 dhe në shumën prej (-) 1.122.332 lekësh në vitin 2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare të krijojë kursimet, si dhe, më pas, këto kursime t'i investojë në pasurinë apartament dhe garazh, në një shumë totale prej (-) 6.147.428 lekësh për vitet 2010 – 2012.
81. Kolegji, në analizë të rrethanave faktike të kësaj çështjeje, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të pasurive, dhe, për rrjedhojë, ai ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
82. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi rezulton se ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera, për pasojë, mbështetur në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm.
83. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 667, datë 26.05.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 667, datë 26.05.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Lazër Sallaku.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 24.04.2024.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*